



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 24.10.2019, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit**

**Rend ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së shkuar të komisionit
2. Konstituimi dhe raportimi i grupeve të punës
3. Prezantimi i paketës së parë, që adreson rekomandimet e ODIHR-it për fushatën zgjedhore, kuotat gjinore, financimin e fushatës, regjistrimin e subjekteve dhe abuzimin e administratës.

**Marrin pjesë:**

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

**Mungojnë:**

Blerina Gjylameti.

**Grupet e punës si vijon:**

Për sistemi zgjedhor:

Damian Gjijnuri dhe Bashkim Fino

Rudina Hajdari; Myslim Murrizi dhe Nimet Musaj

Për financimin e partive politike:

Blerina Gjylameti dhe Klotilda Ferhati

Arben Elezi dhe Ralf Gjoni

Për emigrantët:

Alket Hyseni dhe Adnor Shameti  
Korab Lita dhe Adriatik Alimadhi

## HAPET MBLEDHJA

**Rudina Hajdari** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Përshëndetje të gjithë të pranishmëve!

Kemi disa përfaqësues këtu nga BE-ja dhe nga OSBE-ja.

Fillojmë me rendin e ditës.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së shkuar të komisionit, si pikë të dytë kemi konstituimin e grupeve të punës, që do të raportojnë në lidhje me punët që ata do të bëjnë gjatë javëve në vijim sipas tematikave, po ashtu në këtë mbledhje do të bëjmë edhe prezantimin e paketës së parë që adreson rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për fushatën zgjedhore, kuotat gjinore, financimin e fushatës, regjistrimin e subjekteve dhe abuzimin e administratës. Të gjitha këto janë adresuar në draftin që keni përpara mbi tryezë.

Si fillim, nëse më lejohet, do të mbaj një fjalë hapëse për këtë seancë. Në radhë të parë dua të theksoj që opozita parlamentare është e një zëri për sa i përket një reforme tërësore, gjithëpërfshirëse dhe këtu po përmend edhe ndryshimet e nevojshme kushtetuese që do të bëhen, por edhe ato të parashikuara në objektin e Komisionit të Posaçëm të Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Po ashtu dua të shpreh vullnetin tonë, që në fakt, e kemi shprehur në çdo lloj mbledhjeje, se do të kishim dëshirë që si shoqëria civile, ashtu dhe partitë politike, të cilat nuk janë të përfaqësuara në këtë parlament, të jenë pjesë e këtij procesi dhe të japin propozimet e tyre. Ne i mirëpresim ato propozime, qoftë dhe në distancë.

Në këtë frymë kemi vendosur që në seancën e radhës rekomandimet e OSBE-ODIHR-it të shihen dhe të marrim një opinion edhe nga shoqëria civile, të cilat do të ftohen të marrin pjesë në komisionin e radhës.

Më lejoni të nënvijëzoj, sidomos për maxhorancën, se opozita nuk do të pranojë një proces me dy apo me tri faza, këtë duhet ta dinë të gjithë kolegët dhe ne presim që kolegët socialistë ta kuptojnë këtë kërkesë tonën. Për sa i përket kësaj pike, ne jemi të gatshëm që, brenda nëntorit, të bëjmë propozimet tona në lidhje me ndryshimin e sistemit, të biem dakord të gjithë dhe ta prezantojmë te grupi i punës, i cili do të merret me ndryshimin e sistemit. Kjo është për arsye se ne duam që reforma zgjedhore të jetë e besueshme dhe jetëgjatë, ajo duhet të përshijë të gjitha palët politike, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Ne mirëpresim mendimet e tyre për sa i përket punës që kanë bërë ekspertët në lidhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Në gjykimin tim këto rekomandime janë më shumë të natyrës sipërfaqësore, pra, bazuar në atë që opozita e sotme përfaqëson, ato nuk përfaqësojnë një

ndryshim rrënjësor të marrëveshjes së vitit 2008, prandaj është detyra jonë që të vazhdojmë të thellohemi më tej për të garantuar standardet më të larta të mundshme të zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme, me qëllim që ato të jenë sa më demokratike, por edhe më përfaqësuese në Kuvendin e Shqipërisë.

Drafti i sotëm përqendrohet në nxitjen e barazisë gjinore, në veprimtarinë e institucioneve publike në fushatë, në afishimin e materialeve propagandistike, në donacionet financiare gjatë fushatave, në monitorimin e medieve gjatë fushatës, në fondet e buxhetit të shtetit në dispozicion të subjekteve garuese në zgjedhje, po ashtu dhe në zëvendësimin e vakancave të listave zgjedhore.

Më lejoni të falënderoj ekspertët, të cilët me punën e tyre kanë prezantuar këtë rekomandim, apo këtë draft të parë, si dhe t'ua japim fjalën nëse është nevoja! Dua të falënderoj edhe kolegët që janë të pranishëm dhe e mirëpresim këtë seancë për të diskutuar për draftin paraprak! Këtu do të qëndrojmë në kuadër të diskutimeve dhe nuk do të kemi absolutisht miratime të llojit vendimtar, sepse do të presim shoqëritë civile dhe partitë politike, që janë jashtë këtij komisioni dhe që mund të japin rekomandimet e tyre për këtë draft.

Faleminderit shumë për vëmendjen!

Fjalën e ka zoti Gjyknuri.

**Damian Gjyknuri** – Ju i përmbledhët pak a shumë të gjitha dhe nuk dua të shtoj më shumë për sa i përket anës procedurale se si do të vazhdojmë. Kuptohet, bazuar mbi vendimmarrjen e mbledhjes së kaluar, ekspertët kanë bërë një punë të mirë të bazuar në një punë të bërë tashmë edhe nga komisioni paraardhës dhe që ka marrë edhe mbështetjen e aktorëve të interesuar ndërkombëtarë të asaj kohe.

Siç kemi rënë dakord (natyrisht që ne nuk do të kopjojmë thjesht çfarë është bërë në të kaluarën, pra atë punë të mirë të bërë dhe të pasuruar nga ana e ekspertëve, duke adresuar edhe rekomandimet e fundit që kanë dalë nga raporti i OSBE-ODIHR-it të zgjedhjeve të 30 qershorit), unë kam paraqitur një paketë e cila është e hapur për diskutim për të kapërcyer edhe këtë mangësi, nëse do ta quaja të tillë, apo këtë ngërç politik. Dihet që një pjesë e aktorëve politikë nuk janë pjesë e këtij komisioni apo nuk duan ta njohin këtë parlament, kjo është çështja e tyre dhe ne nuk i pengojmë të kenë konsideratat e tyre politike për institucionet kushtetuese në Shqipëri. Prandaj kemi mundësinë, dhe mua më vjen mirë që ata paskan ngritur një grup, duke e marrë seriozisht çështjen e reformës zgjedhore, që të diskutojmë për këto drafte, të cilat po i paraqesim në komision dhe ata mund të japin opinionet e tyre, qoftë duke i bërë publike, apo duke i sjellë më shkrim në Komisionin e

Reformës Zgjedhore. Kjo mund të jetë një formë komunikimi *sui generis*. Në fund të fundit, e rëndësishme është që opinioni i tyre të reflektohet në këtë Kod Zgjedhor, se nuk na duhet një produkt që mjafton meqë kemi votat këtu në sallë dhe hajde të bëjmë diçka që na leverdis, por një produkt, i cili është i gjithëpranuar nga e gjithë shoqëria shqiptare.

Roli i organizatave joqeveritare dhe i aktorëve të përfshirë në këtë proces është domethënës, sepse pasi t'i miratojmë në parim këto drafte, jo sot, por në mbledhjen tjetër, ku mund ta bëjmë të hapur dhe ta diskutojmë, dhe ku të dëgjohet opinioni i shoqërisë civile dhe i të gjithë aktorëve të interesuar, do t'i çojmë për një opinion paraprak te ODIHR-i për të fituar kohë dhe për të marrë komente informale, në mënyrë që, nëse do të arrijmë konsensusin final politik në linjat që tha bashkëkryetarja, të ecim paralelisht me të gjitha produktet kaq të nevojshme dhe të jemi në kohë për ta miratuar shpejt në Kuvendin e Shqipërisë. E kemi thënë që për çështjen e sistemit, i cili është një proces politik që do të marrë kohë, jemi të hapur pavarësisht nga pikëpamjet e ndryshme personale.

Pa humbur kohë unë do të doja që ekspertët të bëjnë paraqitjen e propozimeve, duke iu referuar rekomandimeve përkatëse se çfarë synohet me këto nene të propozuara nisur nga përvoja negative në të kaluarën, rekomandimet e përfshira në të dhe çfarë synohet pas çdo propozimi juridik që vjen në komision.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për miratimet jemi dakord.

Po, zoti Gjoni.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit!

Unë kam një pyetje që lind nga mënyra e trajtimit të paketës së reformës zgjedhore. Këtu kemi disa propozime, që do t'i quaja kozmetike, sepse nuk besoj se çështjet që po trajtojmë në këtë draft të pjesshëm janë thelbësore, për sa i përket zhvillimit të zgjedhjeve në Shqipëri, por mund të biem në dakord, qoftë edhe në parim, për rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe për këtë draft që na është paraqitur sot, kur këtu ka pika që janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura nga çështjet e sistemit. Për shembull, në nenin 8 thuhet: “Pika 6 ndryshohet për çdo zonë zgjedhore që më pak se çdo tri emra të njëpasnjëshëm në renditje të listës shumëmemërore...” Këtu ne po e marrim të mirëqenë që pranojmë listën shumëmemërore me renditje, kjo varet shumë nga mënyra sesi ne do ta trajtojmë sistemin dhe a është e udhës, pyetje për kolegët, që ne të fillojmë dhe të miratojmë çështje që varen nga ndryshimi i sistemit nëse ju si maxhorancë do të bini dakord. Për këtë unë mendoj që ju si Parti Socialiste të bini dakord brenda jush nëse do të keni vullnet apo jo për ndryshimin e sistemit, për hapjen e listave, sepse, nëse hapen listat dhe listat shumëmemërore nuk janë më me renditje në

përfundim të këtij procesi dhe punës së këtij komisioni, atëherë shumë prej këtyre pikave këtu bien.

**Damian Gjijnuri** – Unë e theksova që këto janë miratime në parim të të gjithë artikujve që do të propozohen, që do të thotë se mbasi të kemi mbyllur këtë proces, ne do të miratojmë tekstin final, i cili ka reflektuar edhe zhvillimet politike jashtë kësaj salle apo brenda kësaj salle, pra nëse ne biem dakord që do të ndryshojmë sistemin zgjedhor, natyrshëm që ato nene do të bien, por neve nuk na pengon asgjë që t'i miratojmë në parim, të marrim opinionin paraprak dhe për të vajtur për votim në Kuvend, natyrshëm do t'i kalojmë sipas procesit që kemi si komision me konsensus, prandaj pyetja jote duket me vend, por adresohet nga procedurat që kemi rënë dakord, nuk po themi që këto janë nene që do të miratohen në Kuvend, sepse nuk ka kuptim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne do t'i miratojmë në parim. Megjithatë, ekspertët mund të japin ndonjë opinion.

**Myslim Murrizi** – Të nderuar kolegë dhe ju dy bashkëkryetarë, unë jam më i drejtpërdrejtë dhe nuk kemi përse shtiremi që ne po bëjmë një gjë të madhe dhe po shpikim raketat, më tepër po bëjmë bujë në mbledhje, sesa realisht bëjmë punë konkrete. Kam dëgjuar disa prononcime publike edhe të kryetarit të grupit tuaj, edhe të deputetit Ulqini që thoni që i keni votat për të mos e ndryshuar këtë sistem. Unë po flas në emrin tim, por besoj edhe në emër të kolegëve të tjerë, nuk keni asnjë votë nga ne. Nëse doni, merrni ekspertët dhe miratoni çfarë të doni, blini deputetët dhe shkoni në Kuvend dhe miratojini! Nga ne nuk keni asnjë votë nëse nuk fillohet nga ndryshimi i sistemit zgjedhor. Nëse keni “buskuqet” dhe nuk keni urgjencë të madhe, përse na i vendosi kushtet Bundesdagu? Nuk i hapi Makron negociatat, a keni folur me të? Përse duhet të bëjmë tri herë shpenzime, ne mblidhemi këtu, ca tek ish-Sheratoni, ca në Dajt. Nuk kam nevojë për peshqirë dhe për flamurë. Nëse ju doni që propozimin e ndryshimit ta bëjë Basha, flisni me të, ashtu siç keni folur prej 10 vjetësh, 29 apo 30 vjetësh. Flisni me ta që ta bëjnë dhe ne do ta votojmë me dëshirë. Kjo nuk është çështje egoje, që ose e bëjmë ne ose ramë e vdiqëm, pra nuk e duam kalë beteje, ne nuk kemi ardhur për të marrë protogonizmin fals, ne kërkojmë atë që kemi paraqitur me 39 firma të deputetëve, ndryshimin e sistemit. Të gjitha këto që kërkon ju, nëse nuk diskutohet në paketë, unë nuk i votoj, besoj edhe kolegët e mi. Çfarë është kjo urgjencë për t'i hedhur sye miletit? Edhe dje ju keni nxjerrë një lloj **aksiqi** pa i informuar mediat. Unë doja të flisja kur ishin mediat këtu, sepse të gjitha mediat e kanë marrë sikur ato ishin ndryshimet përfundimtare të Kodit, pra 26 nenet që ishin “buzkuqe”, pra jo të jenë 6 gra, por të jenë 4, jo kaçurrelë, por sy të zinj, kjo është tallje. E kam thënë edhe herën tjetër, ky sistem është i

qorruar, ndërsa ju thoni t'ia rregullojmë qerpikët. Jo, jo. Unë e deklaroj hapur dhe ai ishte debati që kishim me kolegun Hyseni herën e parë, mua nuk më merr asnjë nga veshi, as nga këta që vijnë vërdallë dhe punojnë në ambasada e as ata që janë përjashta. Mandati i deputetit është mandati im në emër të votuesve që më kanë votuar. Atë që e marrin prej veshi, atë që e kërcënojnë për një vizë, kush është i pistë, kush ka frikë se shpallet *nongrata* dhe kush është hajdut, le të votojë ashtu siç thonë ata, unë nuk i trembem asnjë lloj sanksioni, sepse nuk i kam futur dorën në xhep asnjërit dhe nuk votoj as me telefon dhe as me porosi, shkurt nuk votoj as për këtë që thoni ju.

**Damian Gjijnuri** – Zoti Murrizi, gjithmonë gjërat më mirë bëhen sesa thuhet, ju e keni qëndrimin tuaj dhe unë e vlerësoj. Pak më parë thashë se ne nuk po përjashtojmë asnjë çështje këtu, nuk e di përse i kthehem kësaj teme, sepse kemi rënë dakord, kemi votuar së bashku objektin e këtij komisioni, ku përveç adresimit dhe rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, është edhe çështja e sistemit. Ju kemi dhënë iniciativën e propozimit të sistemit, prandaj po pres nga ju që të vini me produktin përfundimtar për të diskutuar këtu, prandaj ne kemi dakordësi për këtë. Unë them të vazhdojmë me punët tona që janë edhe punët tuaja, sepse të gjitha ndryshimet janë të rëndësishme dhe jemi dakord. Pastaj se si do ta kondicionosh ti votën kjo është puna jote dhe nuk të detyroj. Asnjë nuk ka thënë dhe më vjen keq: “Meqenëse kemi votat, do të bëjmë diçka pa konsensus”. Unë mendoj se do të arrijmë një konsensus më të gjerë për rregullat që u përkasin zgjedhjeve në Shqipëri. Nëse nuk kemi votat e nevojshme, kjo nuk do të bëhet dhe secila palë do të shikojë pozicionin e saj politik përballë çdo partneri, publikut dhe çdo aktori të interesuar. Këtë e them sepse për mua më e rëndësishme është Shqipëria dhe se si do t'i bëjmë këto rregulla më të mira, por të gjitha rregullat kanë rëndësi, prandaj mos të duken kozmetike. Ne mund të shkruajmë çfarë të duash në ligjet në Shqipëri, unë jam dakord me ODIHR-in, i cili ka thënë se zgjedhjet në Shqipëri kanë një kuadër të plotë ligjor për të garantuar zgjedhje të lira dhe demokratike, por problemi është te sjellja e aktorëve politikë. Aktorët politikë në Shqipëri kanë qenë më inventiv sesa ligjet. Ne mund të bëjmë ligje sa të duash, por, nëse aktorët dalin jashtë shinave, edhe pse mund të kemi bërë ligjin më të mirë në botë, përsëri do të ketë probleme, prandaj ta adresojmë këtë paketë nga kjo pikëpamje. Unë nuk thashë që ta çojmë në votim. Zoti Murrizi, së bashku me ekipin tuaj mund të thoni: “Stop, ne nuk e votojmë”, por kjo është çështja juaj dhe nuk kam asnjë të drejtë t'ju detyroj. Ne kemi një dakordësi që t'u japim kohë ekspertëve dhe të fillojmë diskutimet për nenet përkatëse, por nuk kemi thënë se janë të fundit, përkundrazi, në seancën tjetër ekspertët, pasi të ezaurojnë çështjet që do të diskutojmë sot, do të kalojnë në çështjet e administrimit zgjedhor, të cilat janë shumë të rëndësishme. Pra,

sistemi mund t'i duket dikujt i padrejtë apo i drejtë, por sistemi është neutral për të gjithë. Ju mendoni se ka aktorë të rinj politikë, por ku janë, sepse nuk po i shikojmë, apo do të dalin kur të formohen partitë e reja? Po e marrim të mirëqenë sikur ekzistojnë në kokën e ndonjërit dhe do të materializohen me vota, por problemi është se neve na duhen rregulla të qarta të administrimit. Administrimi është shumë i rëndësishëm, është edhe paketa tjetër, në të cilën ata do të punojnë, ndërsa ne do të biem dakord, si nga KQZ-ja, KZAZ-të, komisionet e qendrave të votimit, procedurat e numërimit të votave, pra janë probleme që shumë nga partitë e vogla i kanë pasur në themel të kauzave të tyre, sepse kanë pasur pretendime për administrimin e votës. Me lejen tuaj mund të ecim përpara, në fund mund të bëjmë diskutime, mbasi ekspertët të prezantojnë draftet, mendoj se është momenti që ata të bëjnë prezantimin e tyre duke shpjeguar se cilat kanë qenë arsyet, frymëzimi nga kanë ardhur propozimet dhe ku bazohen ato.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po të ecim tani.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po mundeni po në çfarë kuptimi, për këtë gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adriatik Alimadhi** – Zoti Gjijnuri, ju jeni teknikien i mirë për këtë procedurë, sepse gjithmonë jeni marrë me këtë sistem, me Kodin, me ndryshimet kushtetuese, por edhe me aktet e tjera ligjore që janë derivat të kësaj, përse ju shqetëson fillimi i këtij sistemi ose i kësaj pune të organizuar të këtij komisioni duke e filluar me hierarkinë e ligjeve, pra nga Kushtetuta te ligji dhe pastaj të vijmë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, unë e shikoj se ti nuk do.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju e keni thënë dy-tre herë këtë. Ajo që mua më shqetëson dhe po kuptoj është se ju politikisht nuk doni të bëni ndryshime në sistem...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po si, mor zotëri...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, kanë të drejtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, po përse nuk biem dakord politikisht për ndryshimet në sistem?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Projektin e kemi ne. Ne kemi disa pika që duam të ndryshojmë, çfarë lidhje ka?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta fusim në rend dite dhe ta diskutojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos flisni të gjithë njëherësh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju e keni futur në rend dite dhe keni rënë dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju nuk të lini të flisni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me zhurma e keni shtyrë këta 30 vjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A jeni vërtet ekspertë dhe anëtarë të këtij komisioni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju më duket se doni të shkoni me këtë ligj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çfarë lidhje ka, përse ndërhyti ju? Unë po flas me bashkëkryetarin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po bëjmë tani si...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjiknuri** – Po.

**Bashkim Fino** – Zotërinj bashkëkryetarë, por edhe ju, kolegë, që ju kam përballë, nuk shkon ta fillojmë mbledhjen duke diskutuar, duke u zënë dhe duke filluar diskutime politike për sistemin e të tjera...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord. Ka disa ditë që na keni sjellë në tavolinë një axhendë, ku ju si bashkëkryetarë keni rakorduar dhe keni thënë: miratimi i procesverbalit, konstituimi dhe raportimi i grupeve të punës, ku është edhe grupi i sistemit zgjedhor dhe prezantimi i një paketë të parë të adresuar nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it në fushatën zgjedhore, e cila do të prezantohet sot, do të na lihet kohë që ta lexojmë edhe ne, përveçse që do ta prezantojnë ekspertët dhe do të vijmë përsëri javën tjetër për të vazhduar mbledhjen. Nëse kemi këtë rend dite dhe keni rënë dakord, atëherë hajdeni të vazhdojmë këtë rend dite, se kemi që në orën 09:30, tani është 10:15 dhe ju po bëni diskutim politik.

Zoti Murrizi mund të ketë të drejtë, që dikush nga Partia Socialiste ka dhënë intervistë dhe ka thënë këtë apo atë, por kanë dhënë edhe nga PD-ja apo të tjerë. Ne nuk do të merremi me intervistat që japin jashtë. Ne merremi me këtë komision sipas këtij rendi dite që kemi. A do ta zbatojmë këtë rend dite, zoti bashkëkryetar? Nëse do ta zbatojmë, atëherë hajdeni të vazhdojmë punën! Na e bëni kohën efektive, sepse kam edhe punë të tjera. Nuk kam ardhur këtu që të dëgjoj retorikë politike, as nga ata që janë përballë, as të bëj unë për ju. Dakord? Unë dua të zbatojmë këtë që kemi nisur dhe ju keni rënë dakord. Fillojmë nga kjo dhe vazhdojmë të ecim me punën. Ne jemi një komision në punë, ku do të diskutojmë për të gjitha, për sistemin e të tjera. Të mos bëjmë kot debate. Më vjen keq që ngacmon dhe hedh ndonjë kunj, Ralfi e ka fajin gjithmonë dhe pastaj të gjithë shpërndaheni me radhë.

**Rudina Hajdari** – Ju lutem!

Vetëm për arsye teknike të mos flasim me emra të përvetshëm! Nëse e merrni fjalën, drejtojuni bashkëkryetarëve.

Jam dakord me ju zoti Fino. Do të merremi me këtë rend dite që kemi sot, por do t'i kërkoja bashkëkryetarit se nëse bëhen deklarata mediatike pas kësaj seance duhet të biem dakord që këtu jemi thjesht në kuadrin e diskutimeve, të prezantimit dhe nuk mund të themi në asnjë moment se ne kemi rënë dakord në parim. Nuk ka dakordësi në parim, ne jemi këtu për diskutime për këtë draft që është para nesh. Ekspertët do të na e prezantojnë draftin, ne mund të diskutojmë për draftin ashtu siç zoti Gjoni, shprehu shqetësimet e tij, po ashtu zoti Murrizi, Alimadhi. Jemi dakord.

Zoti Gjoknuri, ju lutem pas këtij takimi nuk mund të thoni në asnjë moment se ne kemi rënë dakord për gjë, sepse e kuptoni qartë që për ne kjo është një pikë shumë sensitive.

Faleminderit!

**Damian Gjoknuri** – Fjalën e kanë ekspertët për prezantimin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Viktor Gumi** - Faleminderit!

Të nderuar bashkëkryetarë,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Kam diçka për sa i përket metodologjisë së hartimit të projektakteve, punës që kemi ndjekur. Sikurse e përmendët pak më parë dhe në bazë të detyrimit që na ka dhënë komisioni materiali bazë mbi të cilin kemi punuar janë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Këto rekomandime fillimisht gjatë komisionit të mëparshëm janë trajtuar në diskutime në mbledhje dhe në tryeza të rrumbullakëta me ekspertë të huaj. Ne e kemi sintetizuar të

gjithë atë pjesë në gjuhë normative, në draftet që kanë ekzistuar edhe në diskutimet paraprake, kemi bërë edhe axhustimet e nevojshme, ndonjë ndryshim, të cilin do ta citoj gjatë neneve të tjera.

Së dyti, kemi pasur si material pune në lidhje me medien në fushatën zgjedhore dhe financimin e fushatës zgjedhor, një material i cili pothuajse ka gati 3 vjet që diskutohet dhe ka marrë formën përfundimtare. Është një projekt i BE-së dhe i implementuar në Shqipëri nga Këshilli i Europës, është projekti aksioni kundër krimit ekonomik në Shqipëri, i njohur ndryshe si “*Horizontal facility*”. Ata kanë angazhuar një ekspert, i cili ka marrë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, bazën legjislative shqiptare dhe ka propozuar këto rekomandime. Ky material është bërë pjesë e punës dhe e metodologjisë sonë. Ne kemi bërë disa axhustime, që i gjykojmë të nevojshme nga ana teknike edhe për hir të teknikës legjislative dhe uniformitetit që ka me pjesën tjetër të ligjit.

Më konkretisht, po filloj me pjesën e parë, me atë komponentin e parë që na keni dhënë detyrim për ta zbatuar si reflektim, që ka të bëjë me kuotën gjinore. Në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it kuota gjinore ka qenë përherë pjesë e observacioneve të tyre dhe e rekomandimeve përkatëse. Ndoshta më pak tonalitet ka pasur në rastet e zgjedhjeve vendore, sepse kanë qenë 50% listat e këshillit bashkiak dhe për pasojë ajo nuk shtrohej gjithmonë si problematikë e theksuar. Ndërsa për zgjedhjet parlamentare OSBE/ODIHR-it i ka thënë përherë çështjet e rekomandimit lidhur me kuotën zgjedhore. Po përmend vetëm 2 prej tyre: rekomandimi i ODIHR-it i vitit 2013, regjistrimi i kandidatëve, rekomandimi nr. 17: “Vëmendje duhet t’i kushtohet promovimit të mëtejshëm të kandidateve gra. Dispozitat ligjore ekzistuese, të cilat lejojnë KQZ-në të ndryshonte rendin e listave të kandidatëve mund të zbatohen, si dhe mund të vendosen gjithashtu edhe sanksione të tjera të mundshme në rast moszbatimi. Gjithashtu, Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të parashikuar pozicion më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të kandidateve gra në listat e partive politike.

Rekomandimi i ODIHR-it për vitin 2017, rekomandimi nr.13: “Mund t’i kushtohet vëmendje forcimit të masave të posaçme ekzistuese për rritjen e pjesëmarrjes politike të grave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo mund të përfshijë detyrimin për alternimin e kandidatëve burra dhe gra në lista, si dhe parashikimin, zbatimin e sanksioneve të efektshme dhe proporcionale, përfshirë edhe mosregjistrimin e listave për respektimin e këtyre masave.

Pyetja është: këto rekomandime, të cilat janë pothuajse të së njëjtës natyrë dhe të së njëjtës gjuhë me të gjitha rekomandimet e tjera, si i kemi zbatuar në tekstin e projektligjit që ju kemi parashikuar?

Kemi menduar të shtojmë në nenin 1, dy pika të tjera, përkufizimi, që ka të bëjë me fjalët “votim për të tretën” ku jepet shpjegimi përkatës, gjithmonë te neni i përkufizimeve, si dhe çështja e votimit familjar, te neni i përkufizimeve.

Kemi menduar që pas nenit 3, në nenin 2 të projektligjit të shtojmë një dispozitë me një karakter të përgjithshëm, gjithmonë jemi në tekstin normativ te pjesa e dispozitës që nuk vendos rregull normativ, por thjesht gjatë interpretimit ajo shërben si mjet i nevojshëm për t’u zbatuar si prej gjykatës, si prej administratës zgjedhore, si prej kudo dhe për t’u ushtruar trysni edhe ndaj organizatave jofitimprurëse kundrejt administratës shtetërore. Listohet në kuadrin e parimeve të përgjithshme edhe një nga synimet që ka Kodi Zgjedhor për të nxitur barazinë gjinore. Dhe kjo do të realizohet nëpërmjet këtyre hapave.

Garantimi i përbërjes jo më pak se 30% të Kuvendit, jo më pak se 50% të këshillave bashkiake, garantimin e përbërjes që do të kenë komisionet e të gjitha niveleve prej jo më pak se 30% të anëtarësisë nga gjinia më pak e përfaqësuar, por njëkohësisht edhe për anën operative të prodhimit të statistike operative që mund të prodhojë KQZ-ja gjatë procesit të votimit dhe më pas për të nxitur gjithmonë dhe më tepër një pjesëmarrje efektive të grave, të gjinisë më pak të përfaqësuar në zgjedhje. Jemi te kuadri i përgjithshëm, kemi menduar se kjo është e vlefshme dhe në kuadër të interpretimit, në fund të ditës e kemi kuotën në Kod dhe atë që e bëjmë e reflektojmë si një nga qëllimet e këtij Kodi.

Në nenin 8 të projektligjit zbatohen rekomandimet që sapo i përmendëm, duke u lidhur edhe me një sanksion të posaçëm. Është ruajtur standardi që 50% e anëtarëve të këshillave bashkiake, pra 1 në çdo 2 emra të jetë i gjinisë më pak të përfaqësuar, ndërsa në lidhje me rizgjedhjet e përgjithshme parlamentare 1 në çdo 3 emra duhet t’i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

Në nenin 23 të projektligjit kemi adresuar çështjen e zëvendësimit të mandateve nisur edhe nga përvoja që ka pasur në parlamentin shqiptar dhe në realitetin shqiptar për një gjë e tillë. Kemi sanksionuar se kjo do të vazhdojë të jetë gjinia më pak e përfaqësuar, nëse krijojmë vakancat, do të vijohet të kalohet përsëri me gjininë më pak të përfaqësuar. Pyetja që u shtrua: po nëse mbarojnë listat e partisë politike, çfarë do të ndodhë? Ne kemi marrë të njëjtin mekanizëm që gjendet në kodin aktual. Nëse një partië që futet si koalicion i mbaron lista e kandidatëve, mandati plotësohet nga partia tjetër e koalicionit. Të njëjtën zgjidhje menduam që ta formulojmë edhe në këtë pikë. Nëse një kandidatë grua nuk plotësohet nga

lista e partisë politike, vijon partia e koalicionit me herësin më të lartë që çon kandidaten grua. Përherë parlamentit i garantohet kjo pjesëmarrje. Pyetja do të lindë: nëse është një parti politike dhe jo koalicion? Atëherë kemi menduar një shifër, e cila është gjobë, në rastet e dorëheqjeve të grave në një vlerë relativisht të lartë 20 milionë lekë të vjetër. Megjithatë këto janë çështje që ju mund t'i diskutoni edhe për vlerën e gjobës dhe për efektivitetin e tyre.

Është parashikuar edhe ndërprerja e mandatit në këshillat bashkiake, ku përsëri kur mbaron një femër, përsëri gjinia më pak e përfaqësuar do të zëvendësohet me gjininë më pak të përfaqësuar. Është edhe një pjesë e dispozitës së sanksioneve, ku mosrespektimi i përcaktimit të bërë si më sipër: këshillat bashkiake 1 në 2 emra dhe në parlament 1 në 3 emra, ka vetëm një pasojë, nuk ka gjobë, por ka refuzim të listës si sanksion.

Për hir të së vërtetës çështja e kuotës gjinore nuk është e programuar 100%, kemi një komponent, të cilin nuk besoj se ne e zgjidhim me formulimet përkatëse, sepse duhet ta plotësojmë këtë komponent të kuotës gjinore kur të vijë problemi i përbërjes së KQZ-së, kur të vijë problemi i KZAZ-ve të nivelit të parë dhe të dytë. Pastaj ndoshta duhet të shikojmë edhe grupet e numërimit nëse do ta vendosim apo jo gjithmonë atë pjesën 30% për sa kohë te grupet e numërimit ka edhe një punë fizike më të rëndë. Është e diskutueshme, nëse do ta vendosim taksative 30% apo do ta vendosim si parim nxitjeje në rastin e grupeve të numërimit, por 30% që ne e kemi parashikuar ta sjellim si pjesë të neneve përkatëse të administratës zgjedhore në nivelin e KQZ-së, në nivelin e parë të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe në nivelin e dytë, cilido që të jetë emri të KZAZ-ja, do të jetë e sanksionuar në këtë pikë.

Në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore, e përmendëm edhe më parë: materiali bazë për reflektim në nenin e Kodit Zgjedhor ka qenë ky projekt i Këshillit të Europës, i cili është dorëzuar zyrtarisht edhe në Kuvendin e Shqipërisë për reflektim. Është një projekt, i cili është parë me ekspertizë vendase dhe të huaj, i është nënshtruar tryezave të debatit dhe ka konkluduar në disa rekomandime konkrete.

Më konkretisht, në lidhje me financimin e fushatës unë kam zgjedhur dy rekomandime, të cilat bëjnë pjesë edhe te ndryshimet përkatëse, sikurse financimi i fushatës është i lidhur edhe me përdorimin e burimeve shtetërore. Në zgjedhjet më të fundit të vitit 2019 ODIHR-i ka thënë, rekomandimi nr. 14: “Duhet të shikohet mundësia e rishikimit të ligjit për të garantuar se KQZ-ja i ka kompetencat dhe procedurat e duhura për të mbikëqyrur dhe për të siguruar zbatimin në mënyrë efektive të financimit të partive dhe të fushatave”. Në zgjedhjet e vitit 2017 dhe në rekomandimin nr.16. ODIHR-i ka theksuar: “Duhet të

harmonizohen rregulla për financimin e fushatës dhe duhet të hartohen akte nënligjore me qëllim që të sigurohet një metodologji solide dhe qasje në informacionin e plotë për financimin e fushatës për ekspertët financiarë dhe zgjedhësit para dhe pas ditës së zgjedhjeve. Mund t'i kushtohet vëmendje përcaktimit të afateve për përfundimin e auditimeve pas zgjedhjeve”.

Në lidhje me rekomandimet të tilla dhe reflektimin e tyre në tekstin e projektligjit, ne kemi parashikuar tek neni 1, neni i përkufizimeve, që të shtojmë fjalët “shpenzime të fushatës zgjedhore”. Është e nevojshme të vendosen këto fjalë, sepse me këtë kuadër do të operojmë gjithmonë te kapitulli përkatës i shpenzimeve në fushatën zgjedhore. Është bërë një huazim, gjë që përbën një praktikë e mirë, e cila është vlerësuar nga zgjedhjet e 2019-ës, madje kam përshtypjen se edhe ato të vitit 2017, që ka të bëjë me afishimin e materialeve propagandistike, rregullim të cilin, efektivisht e kemi te ligji “Për partitë politike”. Ndërkohë, kemi një rregullim tjetër edhe te Kodi Zgjedhor.

Edhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it kanë thënë se këto ligje duhet të harmonizohen dhe të mos bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Prandaj, në nenin 11 kemi aplikuar, kemi riformuluar nenin 79 të kodit aktual zgjedhor, që ka të bëjë me afishimin e materialeve propagandistike.

Në nenin 14 janë kryer dy saktësime, të cilat kanë të bëjnë me nenin 87, pika 6 e 7, si dhe me shfuqizimin e pikës 8 për shkak të riformulimit të dy pikave të mësipërme. Ka të bëjë me faktin nëse një parti politike shpenzon më pak se sa fondet publike që merr, rast në të cilin ajo është e detyruar ta kthejë këtë diferencë në buxhetin e shtetit. Nëse nuk e kthen këtë diferencë për hir të faktit se është para publike, atëherë ndaj saj do të duhet të zbatohen sanksionet përkatëse, deri në mospërfitimin më të tyre për pesë vjet.

Kemi shtuar një dispozitë, e cila është në kuadër të rekomandimit dhe rolit aktiv që duhet të ketë KQZ-ja në fushatën zgjedhore. KQZ-ja duhet të përcaktojë me vendim, me rregullta dhe modalitetet e nevojshme, përlllogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose të shërbimeve të dhëna, kjo sipas vlerës së tregut në momentin e dhënies së tyre.

Pra, shpeshherë vërehej se nuk ishin vetëm financime, në praktikë konsideroheshin dhurime në natyrë, për të cilat është gjithashtu e nevojshme që, më së pari të parashikohen, së dyti edhe të kalkulohet vlera e tyre. Pra, mund të shënohet në faturë një objekt, që unë ta jap për njëmijë lekë, por kalkulimi që do të bëjë institucioni i KQZ-së, sipas metodologjisë së përcaktuar, do të jetë në vlerën e tregut që do të jetë kjo dispozitë, sipas metodologjisë dhe sipas strukturave që do të bëjnë këtë kalkulim, i cili renditet në nenet vijuese.

Në fondet e dhëna për fushatën zgjedhore kemi bërë një ndryshim paraprak nga paratë publike, nga buxheti i shtetit, nga raporti 95 me 5 %, që e kemi ndryshuar disi. 90 % e partive që marrin më shumë se 0, 5 % të votave, kemi shtuar fjalën 10 % për partitë që marrin pjesë në fushatë zgjedhore dhe nuk kanë 0, 5 % të votave. Gjithashtu, në zbatim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, kemi pasur mundësinë që edhe kandidatët e pavarur të kenë akses në financimin e këtij 10-përqindëshi që kualifikohet në këtë dispozitë.

Janë bërë dispozita që kanë natyrë më shtrënguese, sikundër parashikohen në nenin 18. Pra, periudha e ndalimit ndryshohet nga dy vjet në tre vjet. Rasti i ndalimit është, jo vetëm pjesëmarrja në tenderë e në prokurime, në cilësinë e operatorit dhe ofruesit, por gjithashtu të ndalohet edhe pjesa e nënkontraktuesit në lidhje me këto tenderë. Po ashtu, pas fushatës zgjedhore të kemi një periudhë ndalimi proporcionale të marrjes pjesë në tenderë me fonde publike.

Në nenin 90 është po ashtu një ndryshim shumë i rëndësishëm, që kemi parashikuar në lidhje me këtë, mbi bazën e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Deri më sot, pragu mbi bazën e të cilit sigurohet anonimiteti është 1 milionë lekë të vjetra. Ndërkohë, sipas të gjitha studimeve, rezulton se ky prag është shumë i lartë. Kemi menduar që këtë prag, pra që të mos ekspozohet emri i personit, nga 1 milionë lekë të vjetra ta zbrisim në kufirin e 300 mijë lekëve të vjetra, 30 mijë lekë të reja, pak më shumë se paga minimale. Gjithçka mbi këtë prag duhet të jetë transparente, nëpërmjet llogarive bankare, duke mos iu nënshtruar anonimitetit.

Në pikën 3 të këtij neni, të nenit 90 të Kodit Zgjedhor aktual, kemi bërë po ashtu një formulim në kuadër të shpenzimeve të fushatës zgjedhore. Kufiri është dhjetë herë më i lartë. Është shifër stratosferike, nëse do të bëhen llogaritë. Është vendosur balanca e shpenzimeve që do të jenë në këtë pikë, e cila është jo më shumë se dy herë në raport me fondin e marrë nga buxheti i shtetit, nga fondet publike.

Një pjesë e rekomandimeve këtu janë edhe dispozitat që kanë të bëjnë me medianë në fushatën zgjedhore. Ç'është e vërteta, ne kemi bërë një fusnotë në tekstin e paraqitur në këtë material. Kemi thënë se në lidhje me këtë pikë, pothuajse e kemi një draft paraprak. Gjithashtu, materiali i Këshillit të Europës ka rekomandime të qarta në lidhje me këtë gjë. Thjesht për çështje kohore më tepër, por edhe për një diskutim të brendshëm, për ndonjë këndvështrim në lidhje me Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut, për të saktësuar disa formulime, ne kërkuam më tepër kohë, që të mund t'ju sjellim në një periudhë të mëvonshme, kur të kemi një mbledhje tjetër. Është një grup dispozitash, tre a katër dispozita, që kanë të bëjnë me raportet e medias me fushatën zgjedhore.

Në vijim të kësaj pike, ne kemi parashikuar në nenin 90, gjithashtu pjesë e raportimit dhe eksperiencës që ka nxjerrë praktika e KQZ-së, që ka të bëjë me deklarimin dhe publikimin e raporteve zgjedhore.

Publikimi i raporteve zgjedhore, është tashmë një praktikë në përmirësim nga ana e KQZ-së. Ka një model që ata e kanë përmirësuar me hartimin e akteve nënligjore. Ne kemi marrë esencën e këtyre akteve nënligjore, e rekomandimeve që kanë dhënë në lidhje me këtë pikë, ndërsa modularët e raportimit të financave zgjedhore i kemi parashikuar në një dispozitë të veçantë të neni 90, pika 1.

Në nenin 90, pika 2 është një praktikë, e cila ka nisur në vitin 2017, që gjithashtu e kemi përforcuar me disa dispozita e formulime konkrete, që kanë të bëjnë me monitorimin e fushatës zgjedhore.

Pra, në këtë pikë, KQZ-ja jo vetëm që merr raportet, por ka edhe një rol aktiv në llogaritjen e këtyre raporteve. Baza, operatorët që sjellin informacionin e parë për çdo shpenzim gjatë fushatës zgjedhore e për kalkulimet përkatëse, jo në bazë të atyre që deklarohen, por në bazë të metodologjisë që ata përdorin, do të jenë sipas monitoruesve të zgjedhjeve, të cilët janë një trupë e angazhuar nga KQZ-ja, brenda strukturës së saj administrative, që duhet të trajnohet. Është e rëndësishme të krijohet edhe një historik në lidhje me këtë gjë, por ne besojmë se është një mjet efektiv. Ka dhënë disa rezultate dhe gjykojmë se duhet të vazhdojë, për sa kohë është parashikuar si e tillë edhe në rekomandimet ndërkombëtare.

Mbi bazën e praktikës më të fundit, në lidhje me kuadrin e transparencës së financimit të fushatës zgjedhore... Në vlerësimin tonë çështja duhet të jetë sa më transparente, duke krijuar sa më shumë mundësi për këdo, për OJF-të, individët, subjekte të caktuara, për të denoncuar. Në lidhje me këtë, vlerësojmë se është një mjet efektiv edhe krijimi i një portali, që do të mbahet nga KQZ-ja, nëpërmjet të cilit të marrë ankime, dhe si organ administrativ të kryejë hetimin administrativ brenda një periudhe të caktuar kohore. Më pas të dalë me vendimmarrje, e cila do të jetë në diskrecionin total të KQZ-së.

Jo vetëm për këtë pikë, por edhe për të gjitha pikat e tjera, e rëndësishme është se mbi bazën e rekomandimeve kemi rritur afatin e mbikëqyrjes në lidhje me këtë pikë. Tashmë afati nuk qëndron më në dyzet ditë, por fillon gjashtë muaj para ditës së zgjedhjeve, për të vijuar deri ditën e zgjedhjeve.

Pra, nga të gjitha subjektet zgjedhore, parashikohet që këto rregulla të respektohen për një periudhë që gjashtë muaj para ditës së zgjedhjeve e deri në ditën e zgjedhjeve.



Në nenin 21 merr rol KQZ-ja, e cila gjithashtu ka një rol aktiv në hetimin administrativ. Kemi parashikuar që KQZ-ja mund të hetojë çështje të financimit. Hetimi administrativ do të kryhet në përputhje me rregullat dhe përcaktimet përkatëse, që ka Kodi i Procedurës Administrative. Sa i takon praktikave dhe eksperiencave më të fundit, një gjë e tillë është eksperimentuar me sukses nga ana e parlamentit, në kuadër të reformës së drejtësisë në institucionet e vetingut. Ka të drejtë të kërkojë informacion, ndërsa subjektet duhet t'u kthejnë përgjigje kësaj kërkesë të KQZ-së. Mosplotësimi i kësaj kërkesë të KQZ-së, edhe mbi bazën e praktikave të vetingut, përbën shkak:

1-Për marrjen e masave disiplinore.

2- Për kallëzim penal, në përputhje me nenin 48 të Kodit Penal.

Kjo është diçka e rekomanduar dhe e huazuar nga përcaktimet që vijnë edhe me organet e vetingut. Është e kuptueshme se për të gjithë këto elementë, për të gjitha këto pasoja, ne kemi vlerësuar se duhen rishikuar dispozitat e sanksioneve. Për cilindo prej këtyre neneve bëhet një referencë me dispozitë sanksioni. Gjithashtu, dispozita e sanksionit ka minimumin dhe maksimumin e saj.

Ka pasur një diskutim, nëse duhet të përcaktohet një nen i veçantë për kriteret që duhen ndjekur nga KQZ-ja në lidhje me vendosjen e masës, që cili është minimumi dhe cili maksimumi në çdonjërin prej rasteve. Së pari, vlerësojmë se praktika administrative e KQZ-së e ka zgjidhur këtë gjë. Së dyti, si organ administrativ, ajo është e detyruar të zbatojë ligjin “Për kundërvajtjet Administrative”. Në ligjin “Për kundërvajtjet Administrative” vendoset detyrimi dhe parimet që duhet të ketë parasysh çdo organ administrativ në momentin që vendos një gjobë të caktuar, në lidhje me një kundërvajtje të caktuar.

E lidhur ngushtësisht me këtë gjë është edhe çështja e burimeve administrative, ose më saktë çështja e shpërdorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore. Në rekomandimin e zgjedhjeve të vitit 2019, në kapitullin e rekomandimeve kryesore, ODIHR-i shprehet: “Autoritetet dhe partitë politike duhet të ndërmarrin masa maksimale për eliminimin e problemit të hershëm të shpërdorimit të burimeve administrative në zgjedhje dhe në periudhat midis zgjedhjeve. Autoritetet duhet të nxjerrin rregulla të sakta, që përcaktojnë se si mund të përdoren dhe si nuk duhet të përdoren burimet publike për qëllime zgjedhore. Hapa të mëtejshëm duhet të merren për arritjen e depolitizimit të shërbimit civil, për të garantuar mosshtrimin e presionit ndaj zgjedhësve, me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e fushatave zgjedhore apo votim në një mënyrë të caktuar.”

Po ashtu, në vitin 2013 është rekomandimi numër 18: “Abuzimi me burimet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore për qëllime të fushatës, mund të ndalohet në mënyrë

më të efektshme nëpërmjet zbatimit më të mirë të ligjit dhe vënies para përgjegjesisë së personave që e shkelin atë.”

Gjithashtu, është edhe rekomandimi i ODIHR-it nr 13, i vitit 2015, ku theksohet se: “Autoritetet dhe partitë politike duhet të sigurojnë që të mos ushtrohet presion ndaj punonjësve të sektorit publik, mbështetësve politikë apo personave të tjerë, për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës e për të votuar në mënyrë të caktuar. Organet e zbatimit të ligjit duhet të ndërmarrin hapa më të vendosur për të parandaluar, identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e provuara të presionit dhe frikësimit të zgjedhësve, si dhe të keqpërdorimit të burimeve shtetërore për qëllime të fushatës zgjedhore ”.

Kjo është diçka e re, të cilën e kemi propozuar në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve, nuk gjendet gjithashtu në tekstin e paraqitur nga projekti i Këshillit të Europës, ne kemi riformuluar nenin 4. Së pari, gjykojmë se eksperiencia e nëpunësve ndërlidhës për fushatën zgjedhore nuk është një eksperiencë e suksesshme. Kishte disa emërime formale, por nuk kryheshin dhe nuk reflektoheshin përgjegjësitë që duhej të kryheshin për zbatimin e Kodit Zgjedhor.

Kemi menduar që ta riformatojmë këtë pjesë, duke i dhënë një rol kryesor një institucioni, që është KQZ-ja. Tashmë, të gjitha institucionet, si ato të pushtetit vendor, ashtu edhe ato të pushtetit qendror, janë të detyruara të raportojnë paraprakisht paraprakisht në një ndërfaqje të aktiviteve të tyre me karakter publik në një periudhë, e cila fillon kohë para afatit të zgjedhjeve.

Së dyti, kjo ndërfaqje është e aksesueshme në cilësi personale nga sekretaret e përgjithshëm të institucioneve përgjegjëse ose drejtuesit, drejtorët ekzekutivë apo drejtorët e përgjithshëm të këtyre institucioneve, duhet që kjo të deklarohet paraprakisht 48 orë përpara mbajtjes së atij aktiviteti. Kjo krijohet nëpërmjet sistemit online. KQZ-ja është e detyruar ta marrë e ta shikojë këtë si praktikë, jo më vonë se 24 orë pas. Nëse gjykon se kjo është keqpërdorim i burimeve shtetërore, të nxjerrë shënimin “Ndaluar nga KQZ-ja”. Në qoftë se aktiviteti vijon të mbahet, atëherë kjo sjell përgjegjësi penale, sepse është një korsi tjetër që vepron (e drejta penale), por në dispozitën e sanksioneve ne kemi menduar që, gjithashtu, të shtohet një dispozitë si për personat, si për titullarin, me përgjegjësi konkrete, pra me gjobë dhe mënyrë ekzekutimi shumë të shpejtë në rast se thyet ky urdhër i KQZ-së për zhvillimin e fushatës zgjedhore.

Është bërë një reformatim i nenit 88 mbi bazën e këtyre praktikave, pra përdorimit të fushatës zgjedhore që është parashikuar në nenin 17 të projektligjit dhe detyrimin, gjithashtu të KQZ-së, që këto parime të nxirren dhe të reflektohen në akte nënligjore.

Është shtuar në nenin 78, pika 6, një detyrim i subjekteve zgjedhore për të mos u angazhuar në kuadër të praktikave të zgjedhjeve. Besojmë që në këtë pikë është me vlerë të theksojmë disi edhe një formulim të cilin ne e kemi parashikuar në bazën e përcaktimit në Kodin Penal, por që në vetvete kemi redaktuar disi edhe përcaktimin e bërë në Kodin Penal (po flas për nenin 10, i cili shton pikën 6 në nenin 78).

Ajo që gjejmë dhe kemi identifikuar si problematikë të një dispozite përkatëse të Kodit Penal për rastet e shitblerjes së votës është pjesa “ kur bëhet në kundërshtim me legjislacionin në fuqi”. Pra, testi është shumë i lartë në këtë pikë. Duhet të provohet që ekziston një mënyrë që e parashikon legjislacioni, por unë e bëj në kundërshtim me legjislacionin dhe pastaj sjell rastin e blerjes së votës.

Ne e kemi eliminuar në këtë pjesë këtë pikë, pra kemi thënë: praktika, të cilat futen në subjekte zgjedhore si detyrim për këtë gjë. Kjo ndoshta do të duhet të rishikohet se në përgjithësi, edhe nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, nga sa kemi parë, nuk është çështja vetëm se preken aspekte që kanë të bëjnë me Kodin Zgjedhor, por është një paketë më e gjerë që prek që nga praktikat administrative, aktet nënligjore, por, gjithashtu, edhe dispozita të tjera. Ndoshta, një mënyrë është edhe redaktimi i kësaj dispozite të Kodit Penal, duke hequr shprehjen “në kundërshtim me legjislacionin në fuqi”.

Në rastin e regjistrimit të zgjedhjeve kemi bërë disa reflektime, të cilat kanë të bëjnë me një karakter teknik. Janë reflektimet që kanë të bëjnë me:

- rastin e ODIHR-it të vitit 2019, rekomandimi nr.10,
- rastin e rekomandimit të dhëna në vitin 2017, rekomandimin nr. 3,
- rastin e rekomandimit të dhënë në vitin 2013, rekomandimi nr.15.

Këto rekomandime kanë të bëjnë me heqjen automatike të shtetasve, të cilët kanë mbushur moshën 100 vjeç, si dhe të drejtën e votës për personat, të cilëve me vendim gjyqësor u është hequr zotësia për të vepruar.

Këto dispozita janë shfuqizuar. Në dijeninë tonë, edhe në ndryshimet më të fundit, është bërë ligji “Për Gjendjen Civile”. Ndoshta është edhe një çështje që duhet adresuar përkatësisht në atë ligj për të bërë të mundur, si një veprimtari shtetërore, heqjen e këtyre personave nga lista e zgjedhësve, të cilët janë mbi moshën 100 vjeç.

Nëse mënyra që zgjodhën për ligjin “Për Gjendjen Civile” është efektive për të pastruar regjistrat e Gjendjes Civile dhe për pasojë edhe listat e zgjedhësve nga shtetasit që kanë vdekur ose janë mbi moshën 100 vjeç, besoj se është një çështje e cila duhet parë edhe në kuadër të reformimit që mund të ketë ligji i mëtejshëm i Gjendjes Civile.

Për të krijuar një mekanizëm më të efektshëm, i cili parashikohet në nenin 52, të lajmërimit të zgjedhësve derë më derë, së pari, është e rëndësishme të zbatohet në praktikë ai parashikim që parashikon Kodi Zgjedhor. Organeve të pushtetit zgjedhor për këtë proces duhet t'i garantohet një fond i mjaftueshëm për ta realizuar atë. Ne kemi vendosur një mekanizëm raportimi, që kryetarët e njësisve për këtë detyrim që vendos neni 55 i Kodit Zgjedhor një herë në javë ose sa herë kërkohet nga KQZ-ja të bëjnë të mundur, gjithashtu, edhe raportimin për zbatimin e përcaktimit të bërë në nenin 52. Por ajo që ka ndodhur në praktikë dhe kemi vërejtur është se ligji sanksionon që kjo ka një faturre. Fatura përballohet nga buxheti qendror, por në vetvete nuk ka ndodhur, prandaj financimi së bashku me ekzistencën e një raportimi të plotë dhe të saktë do të bëjë të mundur zbatimin korrekt të kësaj dispozite.

Është bërë edhe një diskutim në lidhje me deklarin e kryetarit të partisë politike, atij angazhimi solemn, i cili preket në nenin 7 të projektligjit, ku ne e shtojmë në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, vlerësojmë se është një element i nevojshëm dhe i domosdoshëm, së pari se është detyrim taksativ.

Më konkretisht po ju citoj rekomandimin e ODIHR-it të vitit 2017, në pikën 2 të tij, te pjesa e rekomandimeve kryesore: “Nevojiten përpjekje serioze për të trajtuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës, si nëpërmjet një fushate për ndërgjegjësimin qytetar, ashtu edhe nëpërmjet ndjekjes penale, me qëllim forcimin e besimit të procesit zgjedhor. Partitë politike mund të ndërmarrin një angazhim konkret dhe të mirëfilltë për të luftuar praktikën e blerjes së votës. Gjithashtu, një refuzim publik nga ana e politikanëve për të pranuar mbështetje financiare nga individë me të kaluar kriminale, do të ndihmonte në nderimin e besimit të pabukut në integritetin e zgjedhjeve”.

Rekomandimin e vitit 2015, te pika 15, theksohet se nevojitet një përpjekje shtesë për të trajtuar problemin e vazhdueshëm të blerjes së votës, si nëpërmjet edukimit të zgjedhësve, ashtu edhe nëpërmjet ndjekjes penale, me qëllim rikthimin e besimit në procesin zgjedhor.

Partitë politike mund të ndërmarrin një angazhim konkret dhe të vërtetë për të dënuar praktikën e blerjes së votës. Blerja e votës duhet të përcaktohet qartë në ligj dhe duhet të jetë objekt sanksionesh proporcionale dhe efikase. Në kuadër të kësaj dispozite ne kemi menduar, edhe për shkak të ndërgjegjësimin, edhe për shkak të rritjes së besimit të publikut në procesin zgjedhor, përpara fushatës zgjedhore, një deklarin solemn me shkrim i kryetarëve të partive politike, në emër të partisë si subjekt zgjedhor, është një element i cili nuk i bën keq gjithë frymës së procesit zgjedhor dhe zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Ka pasur edhe një rekomandim me një natyrë teknike. Është rekomandimi nr.11 i vitit 2015, dhe rekomandimi nr. 13 i vitit 2017, që kanë të bëjnë me regjistrimin e kandidatëve dhe procedurën e verifikimit të nënshkrimeve të zgjedhësve. Më konkretisht, në vitin 2017, në rekomandimin nr.13, thuhet: “Për të forcuar më tej transparencën dhe besimin në proces, duhet t’i kushtohet vëmendje dhënies së mundësisë së aktorëve zgjedhorë për të vëzhguar drejtpërdrejt verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse të kandidatëve. Procesi duhet të përkufizohet qartë dhe të përfshijë hapet që duhet të ndiqen në rast se ka ankime”.

Për këtë pikë janë shtuar në nenin 71, pika 4 dhe 5, ku sanksionohet parimi i përgjithshëm i transparencës, e drejta e ankimit të subjektit zgjedhor, gjithashtu, i krijohet mundësia KQZ-së që me anën e akteve nënligjore të përcaktojë modalitetet përkatëse që ka kjo për të zbatuar këtë pikë.

Ne e kemi ndjekur pothuajse të njëjtën taktikë të një ligji që ka miratuar së fundi Kuvendi i Shqipërisë, që ka të bëjë me iniciativën ligjvënëse, ku 20 mijë shtetas kanë të drejtë të paraqesin një projektligj. Edhe aty, gjithashtu, parashikohet çështja e nënshkrimeve. Ky ligj, pavarësisht se ka edhe formën elektronike të tij, gjithashtu, lejon KQZ-në të përcaktojë metodologjinë e verifikimit të nënshkrimeve përkatëse.

Në lidhje me nenin 12 të projektligjit, kemi prekur vetëm një aspekt të medies, për të cilin gjykojmë që nuk ka debat midis nesh për këtë pikë, pra me rezervën përkatëse të atyre neneve të tjera.

Është çështja e bordit të monitorimit të medies edhe në kuadër të administratës zgjedhore dhe në kuadër të rekomandimit për depolitizimin e saj, por edhe në kuadër të efektivitetit që ka ky bord i monitorimit të medies, vështirësive që ka pasur në organizimin dhe funksionimin e tij.

Ne kemi vlerësuar se ky bord mund edhe të hiqet fare nga përcaktimi dhe detyrimet që ka ky bord t’i kalojnë një enti rregullator, sikundër është enti rregullator AMA.

Në fund të ditës, gjithashtu, ky bord shfrytëzon kapacitetet e tij, duke u vënë në dispozicion gjithë mjetet, gjithë stafin, gjithë burimet njerëzore. Për pasojë, duke qenë se është një ent rregullator, i ngritur nga Kuvendi, me përgjegjësi të krijuara me ligj dhe në vetvete kryen të njëjtin funksion, vlerësojmë që pothuajse në të njëjtat shina kompetencash që ka, të ruhen dhe të mbahen ato, vetëm fjala “bord” të zëvendësohet me “enti rregullator i medies audiovizive”.

Është edhe një dispozitë në fund fare, e cila është diskutuar edhe në mbledhjet e mëparshme, që ka të bëjë me çështjen e financimit të fushatës zgjedhore, financimin e partive politike në përgjithësi.

Financimi i partive politike në përgjithësi funksionon mbi bazën e dy ligjeve, ligjit për partitë politike dhe Kodit Zgjedhor që ka të bëjë me fushatën zgjedhore.

Mjedisi më ideal dhe i rekomandueshëm për çështjen e financimit është krijimi i një ligji të vetëm që të rregullojë çështjet e financimit të partive politike nga a-ja te zh-ja, ku përfshihet gjithashtu edhe çështja e financimit të fushatës zgjedhore.

Është një proces më i gjatë, është një proces që shkruhet me reflektime, me praktika, me diskutime të gjera dhe vlerësuam, për hir të kësaj periudhe kohore, të gjejmë një zgjidhje, e cila ngelet në vlerësimin tuaj.

Këto dispozita të jenë pjesë e Kodit Zgjedhor dhe të vazhdojnë të jenë të tilla deri në momentin që do të hartohet një ligj i ri organik për financimin e partive politike. Në momentin që do të rregullohet ky ligj i ri, me çfarëdo oversajdi mbikëqyrjeje mund të ketë për këtë gjë, këto dispozita të shfuqizohen. Por kjo është një çështje që, gjithashtu, ngelet në kuadër të vendimmarrjes suaj politike, por ne thjesht e sollëm meqenëse në debatin e parë u diskutua edhe çështja e financimit dhe raportet që mund të kenë dy ligjet nesër apo pasnesër.

Përgjithësisht këto janë amendimet që kemi parashikuar në tekstin e projektligjit.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit, zoti Gumi!

Falënderoj ekspertë për punën e bërë.

Përpara se të kalojmë te pyetjet, urdhëroni zoti Rusmali!

**Ilir Rusmali** – Unë nuk dua t’ju bezdis shumë. Prezantimi ishte i plotë.

Unë dua të ndalem vetëm në tri çështje, që mendoj se kanë vlerë të rrinë në vëmendjen tuaj.

Së pari, Viktori tha se nevoja për reformimin e Bordit të Monitorimit të Medieve vjen nga rekomandimi kryesor që jep raporti i ODIHR-it, ai i depolitizimit të strukturës së administratës zgjedhore. Bordi i Monitorimit të Medieve është strukturë politike, për fat të keq, e cila nuk ka qenë efiçiente. Ne propozojmë një zgjidhje alternative. Sot për sot kapacitetet teknike për monitorim i ka vetëm AMA në Shqipëri; shfrytëzohen kapacitetet e saj. Ne mendojmë se monitorimi në vetvete është proces teknik dhe bëhet atje ku janë kapacitetet teknike. AMA do të bëjë vetëm monitorimin dhe do të prodhojë raporte, të cilat duhet të jenë të aksesueshme nga publiku. Njerëzit duhet ta dinë se çfarë thotë AMA në raportimin e saj të rregullt, maksimumi njëjavor, si dhe subjektet elektorale duhet të kenë mundësinë të reagojnë ndaj saj; duhet të kenë mundësinë të reagojnë mediet, por edhe shoqëria civile.

Kompetencën lëndore për monitorimin ne ia lëmë KQZ-së, sepse kjo e fundit gjykon monitorimin, raportet; KQZ-ja është ajo që gjykon për denoncimet dhe për informacionet

alternative, që vijnë nga burimet alternative dhe pastaj është ajo që merr masat, sepse nuk i merr dot AMA masat, madje ndaj asnjë medieje në këtë fushë. Besoj se ka rëndësi që ta kemi të qartë këtë për të kuptuar se ndryshimi që ne propozojmë nuk është rrënjësor, por është ndryshim teknik dhe i rregullon më mirë raportet ndërmjet palëve pjesëmarrëse.

Së dyti, lidhur me diskutimin për sa i përket keqpërdorimit të burimeve shtetërore, propozimi që ne ju bëjmë për monitorimin e përdorimit të këtyre burimeve është që të bëhet nëpërmjet portalit të KQZ-së. Ne jemi nisur nga një konsideratë. Sot në opinionin teknik ka një qartësi ekstreme për format dhe metodat e keqpërdorimit të burimeve shtetërore. Kudo, edhe ndërkombëtarët, edhe shqiptarët e dinë cilat janë lojërat që bëhen; e dinë cilat janë skemat që përdoren.

Ajo për të cilën vuan Shqipëria është fakti se ne nuk kemi një mekanizëm efikas për ta bllokuar këtë gjë. Ne mendojmë që ne e rrisim mjaft potencialin e KQZ-së për të ndërhyrë në proces, në qoftë se ne i japim instrumente ndërhyrjeje dhe instrumenti i ndërhyrjes është e drejta për të ndaluar veprimtaritë shtetërore, e para; është operativ, i menjëhershëm, i shpejtë që, për shkak se është publik, është edhe i efektshëm. Pra, nuk duhet shumë për të bërë debat.

Konsiderohet që është keqpërdorim i burimeve shtetërore, publikohet ky qëndrim i KQZ-së; kjo e fundit ndalon dhe të gjithë e shohin, sepse ndërveprimi është publik.

Raportimi i organeve shtetërore për aktivitetet e tyre gjatë fushatës, gjatë periudhës që ne kemi caktuar, duhet të jetë publik. Të gjithë duhet ta shohin këtë aktivitet, ndërkohë që edhe reagimi i KQZ-së duhet të jetë publik. Në momentin kur gjërat janë publike, njerëzit janë në gjendje ta marrin në konsideratë, ta shohin, ta shqyrtojnë, ta vlerësojnë. Besojmë shumë se kjo do ta frenojë shumë keqpërdorimin.

Elementi i dytë që ne japim dhe që besojmë se do të sjellë efekt është mundësia për KQZ-në për ta katalogizuar zyrtarisht fenomenin, për të thënë paraprakisht cilat janë aktivitetet që ne do t'i konsiderojmë si keqpërdorim të burimeve shtetërore. Është mirë që atë, që e thonë nëpër seminare, shqiptarë dhe të huaj, ta kemi në një dokument të KQZ-së, ku të thuhet: "Ky lloj aktiviteti, minimalisht, katalogizimi i llojeve të veprimtarive, i cili duhet të jetë një proces dinamik...". Në qoftë se administrata do të shpikë forma të reja keqpërdorimi, duhet të azhurnohet katalogu i KQZ-së për shkeljet. Besojmë se ky mekanizëm do të sjellë efekt.

E treta, për ta mbyllur, që ka lidhje pak edhe me debatin tuaj fillestar, cili është perceptimi ynë si teknikienë, në raport me veprimtarinë e komisionit tuaj dhe me të gjitha strukturat që funksionojnë si komisioni juaj? Ju nuk e mbyllni veprimtarinë në një mbledhje dhe nuk e mbyllni me një vendim, por vendimet tuaja janë vazhduese dhe kurorëzohen me

një dokument përfundimtar. Kjo për ne si teknikienë do të thotë që çdo vendim juaji i mëvonshëm, që bie në kundërshtim me një vendim tuajin të mëparshëm, është detyrues për ne. Ne do të marrim të mëvonshmin si më të rëndësishëm. Në këtë këndvështrim, diskutimi dhe vendimmarrja juaj për sistemin do të ketë impaktin e domosdoshëm mbi gjithçka që ka kaluar përpara. Ne nuk mund të themi që nuk e pranojmë sistemin, sepse kemi miratuar nenin “iks”. Besoj se nuk keni për ta thënë këtë, por duhet ta dini se ky është impostimi ynë. Ne e mirëkuptojmë faktin se vendimi i dytë anulon të parin dhe do të reagojmë si teknikienë me këtë logjikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe dy fjali dhe e mbylla.

Kjo ka rëndësi për debatin rreth barazisë gjinore, i cili është mjaft i rëndësishëm dhe parimor, pasi ka jo vetëm detyrime që na vijnë nga angazhimet ndërkombëtare, në radhë të parë, nga OSBE-ja dhe nga Këshilli i Europës, por ka edhe detyrime që na vijnë nga legjislacioni shqiptar që është sot në fuqi. Duam apo nuk duam, duhet ta respektojmë barazinë gjinore.

Ajo që ne reflektojmë si rekomandim në këto amendamente nuk ka lidhje me sistemin realisht, pavarësisht se ne flasim për lista të mbyllura, të cilat mund të modifikohen nesër, por ka lidhje me parimin: “Barazia gjinore është parim i procesit, apo është parim i rezultatit; ka rëndësi ta kemi në fushatë, apo ka rëndësi që organet, të cilat dalin nga zgjedhjet, ta kenë pjesë përbërëse të tyre”?

Rekomandimet thonë se duhet të jetë pjesë përbërëse e organeve që dalin nga zgjedhjet, jo e fushatës dhe ne jemi përpjekur, si të thuash, të reflektojmë, me aq sa ne kemi pasur mundësi duke bërë maksimumin tonë, këtë lloj parimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalja e fundit. Në qoftë se ju sot pranoni këtë formulim që është këtu, nuk keni pranuar listat e mbyllura, por keni pranuar parimin që barazia gjinore duhet të jetë në rezultat, duhet të jetë e organit, pra jo e procesit.

Në qoftë se nesër do të merrni vendimin për një sistem me lista të hapura, është detyra jonë të gjejmë mekanizmin që parimin e barazisë gjinore ta adoptojmë te listat e hapura. Kështu e kemi perceptuar ne gjënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, teknikienët për këtë punë janë. Kështu që mos na paragjykoni pa na provuar! Kur të dorëzohemi ne dhe të themi: “Nuk e realizojmë dot”, pastaj na thoni: “Keni qenë me hile, keni qenë të paaftë e me radhë”.



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Por më besoni, ka mekanizma për të gjitha!

Faleminderit dhe, njëherazi, më falni që ju bezdisa!

**Damian Gjikhuri** – Zoti Rusmali, më vjen mirë që bëtë një narrativë të shtjelluar të prezantimit që bëri zoti Gumi, duke adresuar edhe disa elemente, të cilat, jam i sigurt, teksa dëgjonim prezantimin e zotit Gumi, lëvrinin në mendjen e gjithsecilit këtu.

Është shumë e rëndësishme, pasi shpjegimet tuaja shteruan edhe disa nga çështjet e ngritura më parë. Realisht, në fund të fundit, ajo që ju thatë (dhe unë doja ta bëja si përmbledhëse pas prezantimit të zotit Gumi), ma thjeshtoi punën, duke ditur se keni qenë edhe ish-bashkëkryetar, pra lehtësohet puna nëse ke ekspert, me eksperiencën e asaj çfarë na shqetëson ne për pjesën politike të këtij procesi. Ju e bëtë fare mirë. Pra, janë dy-tri gjëra shumë të guximshme aty, që dua t'i theksoj edhe unë, pa rënë në përsëritje të atyre që tha zoti Rusmali, por që duhet t'i marrin vesh edhe të tjerët, se ne, pa dashje, duke u fiksuar vetëm te një pikë, harrojmë disa detyrime të mëdha që i vëmë vetes, jo vetëm ne si ligjvënës, por në përgjithësi e gjithë administrata, që do të ngarkohet nga ky ligj, për të pasur një fushatë të barabartë dhe transparente.

Do të thosha që disa nga detyrimet aty (dhe këtu po flas disi politikisht) janë të barabarta me gati një gjysmë qeverie teknike. Në qoftë se gjashtë muaj para zgjedhjeve (dhe ky është shumë i fortë si propozim, nuk themi se do ta pranojmë apriori, sepse kjo ka debat, madje edhe unë vihem në pozitë shumë të vështirë nga ana politike) ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, të lutem, tha: “Gjashtë muaj para zgjedhjeve ka detyrimin...”!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, përveç pjesës së raportimit!

Pra, gjashtë muaj para ditës së zgjedhjeve, qeveria ka detyrimin që praktikisht të mos bëjë asnjë aktivitet të karakterit politik. Me atë që tha zoti Rusmali, pra se katalogizimi ose profilizimi i këtyre aktiviteteve do të krijojë një traditë të konsoliduar, praktikisht, ne po shkojmë (në thonjëza duket, por një lloj *proxy* është) drejt një qeverie gati gjysmë teknike. Pra, qeveria nuk kryen më asnjë aktivitet politik. Periudha gjashtë muaj është jashtëzakonisht e gjatë, që, normalisht, pretendohet se partia në pushtet e shfrytëzon për të mobilizuar faktorët e saj për të arritur avantazhe, që, zakonisht, t'i jep pushteti (gjithnjë pushteti ka kosto të mëdha, por ka edhe disa avantazhe). Ky avantazh deri diku me këtë detyrim, nëse zbatohet, neutralizohet. Kështu që për mua është një propozim shumë radikal, për të cilin doja të tërhiqja vëmendjen.

Megjithatë, për të vazhduar, kam një sugjerim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo vërejtje, më shumë është sugjerim i karakterit teknik që ju, së bashku me administratën e komisionit të Kuvendit, herën tjetër, përfshirë edhe këtë draft, krahas neneve aktuale të Kodit Zgjedhor, të vini në një tabelë krahasuese edhe propozimet, në mënyrë që deputetët ta kenë shumë të thjeshtë për ta ndjekur si ka qenë dispozita që është sot në fuqi, dhe si ndryshon ajo me propozimin tuaj.

Pra, ju lutem, bashkë me administratën, besoj është shqetësim edhe për kolegët, të ketë një tabelë krahasuese, në mënyrë që ne të shikojmë dhe të *track*-ojmë të gjitha ndryshimet. Besoj se kjo e bën edhe më të thjeshtë debatin dhe diskutimin tonë.

Përpara se të kalojmë te pyetjet, do të kërkoja të bëhen pyetje rreth draftit, qëllimit, mënyrës se si argumentohet e të tjera, ndërsa diskutimet do t'i lëmë pasi të ezaurohen pyetjet, ndoshta mund t'i lëmë për herën tjetër, pasi të marrim kohë të gjithë ne për ta lexuar dhe për ta përpunuar këtë draft.

Zonja Hajdari, doni të shtoni diçka?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rudina Hajdari** – Në fakt, kam vetëm një koment të shkurtër.

Më duhet të largohem, por, para se ta bëj këtë, dua t'i falënderoj ekspertët për prezantimin e tyre! Madje, do të kisha dëshirë që takimi të vazhdonte qoftë me pyetjet dhe diskutimet që kanë anëtarët e opozitës, në lidhje me atë që ju shprehët.

Gjithashtu, ne nuk e diskutuam dot çështjen e ndarjes së grupeve të punës, që është një gjë shumë e rëndësishme. Në fakt, propozimet janë duke u depozituar pranë komisionit të reformës zgjedhore. Nëse ka ndonjë ndryshim sa i përket ndarjes së grupeve të punës, ju lutem, ky është momenti që t'i ndajmë në mënyrë përfundimtare.

**Damian Gjijnuri**- Unë mendoj se për grupet e punës kemi rënë dakord. A ka ndonjë sugjerim?

Zonja Hysi, edhe me dakordësinë tuaj, unë mendoj të koordinojmë punën, meqenëse këtu kemi çështjen e barazisë gjinore, kushdo nga krahu tjetër i kësaj tavoline mund të koordinojë bashkë me OJF-të çështjet e barazisë gjinore. Meqenëse i kemi këto produkte në tavolinë, të diskutojmë edhe për çështjet e kuotave për të koordinuar këtë proces në vazhdim.

Atëherë, a jeni dakord që të caktojmë zonjën Hysi si përgjegjëse? Besoj se person më të spikatur në grupin e PS-së nuk mund të gjejmë.

Para se të kalojmë te pyetjet, ju lutem, grupet e punës duhet të merren me disa çështje që janë shumë delikate.

Adnor, kjo do të thotë që së bashku do të filloni kontaktet në koordinim edhe me ekspertët, që patjetër janë në dispozicion të grupeve të punës, për të trajtuar çështje për të cilat ata janë ngarkuar. Kjo punë duhet të fillojë, ne i miratojmë në parim.

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit!

Unë do të mirëprisja të kisha edhe një koleg nga opozita për barazinë gjinore. Do të punojmë së bashku shumë mirë. Ne kemi shumë materiale dhe informacione që na kanë sjellë jo vetëm OSBE-ODIHR-i, por edhe nga tryezat që janë bërë. Kemi materiale të depozituara nga vëzhguesit vendorë, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët kanë bërë shumë punë të mirë dhe nuk besoj se kemi shumë punë sa u përket çështjeve të barazisë gjinore dhe të gjuhës gjinore në legjislacion. Kështu që do ta vlerësoja shumë që të ishim në grup pune me njërin prej jush dhe të diskutonim. Unë mendoj të zgjedh zotin Nimet. Unë jam e bindur se edhe ju burrat do ta ndryshoni edhe gjuhën e komunikimit në këtë komision, por edhe në legjislacion.

**Damian Gjikhuri** - A jeni dakord me propozimin e zonjës Hysi?

Po, dakord.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, grupi i parë për çështjet e barazisë gjinore dhe koordinimin me të gjitha organizatat e interesuara për këtë çështje do të përbëhet nga Nimeti dhe Vasilika. A jeni dakord?

Miratohet.

Sa i përket çështjes së sistemit, cili është propozimi juaj? Ne i kemi anëtarët, por cili është propozimi juaj për anëtarët tuaj?

**Ralf Gjoni** – Ideja është që Nimeti ka më tepër eksperiencë nga ana financiare dhe do të jetë një kontribut shumë i vyer te pjesa e grupit të punës së financave. Duke qenë se unë e kam merak këtë punën e sistemit dhe e kam edhe si kauzë politike të futjes sime në parlament, do të doja të isha pjesë e grupit të punës.

Kam një pyetje: si do të funksionojnë grupet e punës? Pra, çfarë peshe do të kenë këto grupe? Unë mendoj se grupet e punës po krijohen si shtojca alibie anash Kodit Zgjedhor, bazuar në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

**Damian Gjikhuri**- Grupet e punës janë për të diskutuar çështje të veçanta që duan diskutim politik, pra për ato çështje që i quajmë të mprehta. Grupet e punës në konceptin e traditës së Kuvendit, së bashku me ekspertët ose me kë të doni ju do të diskutojnë, për shembull kur të sillni draftin e sistemit, do ta keni diskutuar në grupin e punës para se të vini në mbledhjen e komisionit, e njëjta gjë edhe për draftin për financimin e partive politike.

Nëse nuk bini dakord, çështja do të shtrohet në komisione. Ky është një filtër që ne mund të arrijmë në konsensus në një nukël më të vogël dhe e kemi më të thjeshtë punën tonë.

Atëherë, grupi për sistemin zgjedhor do të përbëhet nga deputetët: Damian Gjijnuri, Bashkim Fino, Myslim Murrizi, Ralf Gjoni dhe Rudina Hajdari.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, edhe ne do të propozojmë edhe një anëtar.

Grupi për çështjen e financimit të partive do të përbëhet nga deputetët: Nimet Musai, Arben Elezi, Blerina Gjylameti, Klotilda Ferhati.

Grupi për çështjen e emigrantëve do të përbëhet nga deputetët: Alket Hyseni, Adnor Shameti, Korab Lita, Adriatik Alimadhi. A jeni dakord?

Miratohen vendimet.

Kalojmë te pyetjet në lidhje me draftet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Myslim Murrizi** – Kam dy-tri pyetje. Një pjesë i mendova gjatë prezantimit të zotit Gumi, por e mora përgjigjen nga komenti më konciz i zotit Rusmajli për kuotat gjinore që ne kemi. Me sa di unë ato janë të sanksionuara në Kodin Zgjedhor që ne kemi. Pse duhet gjithë ky shpenzim kohe? Në Kodin Zgjedhor të vitit 2008 30% duhet të jenë zonja, pra 1 zonjë në tre kandidatë. Kur nuk e kemi respektuar këtë rregull, jemi ndëshkuar me gjobë. Në zgjedhjet e fundit të vitit 2012, te këshilltarët e kishim 50%. Pra, cila është risia që propozohet nga ju si ekspertë, përderisa janë në Kodin Zgjedhor?

Për cilin nga vendet e BE-së të keni informacion për kuotat gjinore, ju lutem, të na i sillni, mbase sot nuk i keni, por mbledhjen tjetër. Me aq sa unë kam parë, jo BE-në, kam parë senatin dhe kongresin amerikan, senati amerikan ka 18% femra, ndërsa kongresi ka 21% femra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po mirë, Amerika çdo gjë e bën gabim, veç ne dhe shoku Enver i bëjmë mirë. Ata nuk dinë gjë. Ju lutem, më lini të mbaroj!

A doni ta bëjmë 70% gra? Po këtë e shoh si diskriminim pozitiv. Pse 30%, ta bëjmë 70%. Unë i kam shumë qejf gratë, madje Rama në këtë kuadër po e bën një burrë, një grua partinë, një burrë, një grua dhe dy kalamaj dhe një kryetar partie.

Mos ndërhyuni!

Pra, unë desha të di cili është raporti i gjinisë që kanë vendet e BE-së dhe raporti që ka Parlamenti European për kuotat gjinore? Edhe këtë punën e këshillit kush e ka në këto vende, na i thoni 1, 2, 3. Unë nuk jam kundër.

Çështjet e financimit të partive, shitblerja e votës dhe përdorja e aseteve shtetërore të administratës të zgjedhjet, a mendoni se zgjidhen me Kod Zgjedhor, apo me Kod Penal? Unë nuk besoj se ne kemi pasur problem në financimin legal të partive, pra pjesën e dukshme, sepse vjen Shefqet Kastrati e jep 50 mijë euro të Damiani dhe 50 mijë tek Oerdi, si ta shohë ai pushtetin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mua nuk më kanë dhënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Naftë të jep ty, Oerdit ndonjëherë.

Pra, unë nuk e shikoj problemin e financimit të partive të pjesa legale. Ato emra që partitë publikojnë formalisht janë pjesë e dukshme. Si zgjidhet me Kod Zgjedhor? Unë mendoj se është tagër i Kodit Penal për të kapur financimet nën rrogë, sepse të pjesa legale nuk ka problem, por tek ajo që partitë do të bëjnë për të na hedhur hi syve, do të marrin listën e anëtarësisë nga 100 mijë anëtarë do t'ju presin nga një mandat 300 mijë lekë dhe do të thonë u bënë 3 milionë euro. Pra, si zgjidhet kjo? Unë mendoj se më shumë duhet hyrë, mbase duhet një vullnet më i madh për ta riparë në kompleks Kodin Penal. Çfarë do t'i bëjë KQZ-ja kapjes, shitblerjes apo financimit të partive politike, të cilat duan ta frenojnë këtë me Kodin Zgjedhor?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Sa i takon financimit të medieve, a do të ishte më mirë që mediet, e pashë gjatë prezantimit që bëtë, të mos financoheshin drejtpërdrejtë nga partitë politike, por partitë politike të detyroheshin që nga financimet legale që u takojnë qoftë nga buxheti i shtetit, të cilat deklarohen me fatura, pagesën për fushatën ta merrnin në njëfarë mënyre nga buxheti i shtetit?

Pra, nga buxheti i shtetit Partisë Demokratike i takojnë 500 milionë lekë, nga të cilat 30 milionë janë për mediet dhe do t'ia japin drejtpërdrejtë Klanit, Top Chanel-it, Vizionit e të tjera, duke mos marrë para nga partitë politike me kuotë të drejtpërdrejtë, sepse në këtë mënyrë nuk arrijmë ta kuptojmë. Ata shprehen se i kanë paguar partitë, por sesa nuk e tregojnë.

A mos do të ishte më mirë që mediet kombëtare, ato që e kanë një licencë të tillë, ta merrnin financimin për të reklamuar fushatën e partive nga buxheti, qoftë nga kuotat që ka partia apo qoftë nga buxheti që i takon partive nga KQZ-ja në mënyrë që mediet të paguheshin nga shteti dhe ne do të ishim në rregull?

Këto ishin pyetjet që unë kisha.

Ju faleminderit!

**Ilir Rusmali** – Faleminderit, i nderuar deputet!

Po e filloj nga pyetja e fundit. Ne jemi frenuar tek amendamentet për mediet, sepse kemi ende një debat teknik, ndoshta edhe pak të ashpër me njëri-tjetrin, prandaj ende nuk i kemi dërguar përpara. Paraprakisht dua t'ju them diçka në raport me fushatën elektorale dhe për mediet ka gjithmonë brenda një diskutim që është hileqar. Diskutimi është: marrëdhënie biznesi apo është liri e medias? Rregullimi që i bëhet këtij procesi është rregullimi që i bëhet një biznesi apo lirisë për të informuar? Sa herë është trajtuar kjo çështje aq herë ka shkuar në rrugë të gabuar. Sa herë ka pasur tentativa për të rregulluar, për të disiplinuar dhe për të vënë korniza te procesi ka pasur një reagim shumë të ashpër nga mediet dhe na është thënë: “Po cenohet liria jonë”.

Në fakt, raporti dhe ideja që hidhni ju rregullohet nga ligjet e biznesit dhe jo nga ligjet e medias, pra nga ligjet e fushës. Në qoftë se ne operojmë me këtë lloj mekanizmi për ta pastruar fushën nga hilet, caktojmë një kuotë për mediet, në këtë mënyrë po disiplinujmë një veprimtari tregtare, nuk po disiplinujmë një veprimtari mediatike. Gjëja mund të jetë racionale, mund të ketë interes, mund të jetë kjo rruga që zgjidhet, por duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin që jemi duke disiplinuar lirinë e veprimtarisë tregtare. Po u themi dy palëve që hyjnë në marrëdhënie tregtare me njëra-tjetrën, që ju nuk do të hyni në marrëdhënie tregtare, por do të bëni çfarë ju thonë partitë politike dhe para do të merrni kaq se kaq ju kam thënë unë.

Përgjithësisht, veprimtaria tregtare nuk disiplinohet...

*(Diskutime pa mikrofon)*

... kjo do të thotë që ne duhet të rregullojmë marrëdhënien tregtare nga A deri te Zh-ja, sepse përndryshe nuk e disiplinujmë dot, do t'i bëjnë marrëveshjet nën rrogoz, do t'i shkëmbejnë paratë nën rrogoz dhe do të bëjnë sikur e kanë respektuar ligjin.

Për të rregulluar marrëdhënien nga A deri te Zh-ja ka disa forma, të cilat do t'i shqyrtojmë bashkë me ato dhjetë të tjerat, për të cilat po zihemi me njëri-tjetrin se cila është më e vlefshme dhe më pas do të vijmë t'ju raportojmë. Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm, sepse është shumë e rëndësishme, që është marrëdhënie tregtare. Çfarëdolloj zgjidhjeje që do t'i jepni ju, akuza e parë do të jetë që u cenua liria e medias, nuk i shpëtoni dot kësaj, prandaj duhet ta përballoni ose lërinë kështu siç është.

Gjëja e parë që do t'ju thonë, do t'ju gënjejnë publikisht, cenuan lirinë e medias, çdo lloj disiplinimi, cenuan lirinë e medias. Në fakt, është marrëdhënie tregtare biznesi me

interesa shumë të fuqishme brenda, prandaj mbrohet me aq xhelozë nga pronarët, jo nga gazetarët.

Kuotat gjinore.

Edhe këtu ka një lloj arsyesimi që ndoshta e bën pak të komplikuar gjënë. Ndërkombëtarisht, mekanizmi, ndoshta Vasilika do të më korrigjojë, i kuotave gjinore është shpikur për të emancipuar shoqëritë që janë të paemancipuara, duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë punë. Në momentin që e pranojmë këtë gjë duam kuotën se jemi ende të paemancipuar, por nuk mund të krahasohemi dot pastaj as me Gjermaninë, Francën, Finlandën, Suedinë dhe as me Islandën, sepse atje kanë problemin e kundërt, gratë janë aktive në politikë, ndërsa burrat janë më shumë të orientuar drejt fushave të tjera dhe nuk i nxisin burrat të merren me politikë, pra ato janë shoqëri të emancipuara. Ne duhet të pranojmë faktin që hyjmë te shoqëritë ende të paemancipuara dhe për shkak se jemi të tillë, ka dokumente pa fund të Këshillit të Europës edhe të OSBE-së në raport me këto të demokracisë, që kërkojnë që për vende si Shqipëria të planifikohen kuotat gjinore. Mekanizmi që ata kanë si nxitës për promovimin e gruas në shoqëri dhe në politikë është mekanizmi 30%. Shumica dërmuese e dokumenteve e kanë mekanizmin 30%.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Prit pak, të lutem!

Nëse është i drejtë mekanizmi 50 apo 30%, mund të kemi opinione personale. Unë personalisht besoj se nëse duhet promovim, pra duhet të nxitet një proces 30%-i është dysheme. Çfarë do të thotë nëse e vendos 30%-in dysheme? Po vure 50%-in dysheme nuk ke më as dysheme dhe as tavan, por ke një burrë dhe një grua, ndërkohë që ne duam të promovojmë dhe të nxisim proceset dhe procesin e jep dyshemeja këtu dhe pastaj ecën përpara kjo gjëja. Për këto arsye kisha rezerva...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo është gënjeshtër, më dëgjo mua.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, e shoh që do të më fusësh në sherr me Vasilikën, por nuk do të ndodhë.

Duhet të pranojmë faktin që këto janë procese të rëndësishme dhe afatgjata...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Përpara disa vitesh një pjesë e organizatave të grave kërkuan kuotën 40% dhe atëherë opinioni im personal, sepse tani do të flasim për opinionet personale nuk kemi se çfarë të bëjmë, ka qenë se ishte lëvizje e gabuar. 30%-i plotëson nevojën, sepse është dysheme,

ndërsa pjesa tjetër është përmirësim nga nevoja. Në këtë kuadër bashkëkryesimi i strukturës politike është përmirësim nga nevoja, por duhet të jetë i plotë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Një burrë dhe një grua do të jetë shumë mirë, por duhet të jetë deri në fund.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nëse duam të dimë se cilat janë vendet e tjera që kanë kuotë ato i kemi të gjitha rreth e përqark. Nuk e kemi në Francë apo në Gjermani kuotën, atje e kanë për pjesëmarrjen, nuk e kemi në Itali eventualisht...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Greqia mund ta ketë, por kini parasysh një gjë, kriteri është emancipimi i shoqërisë nuk është se cili vend e ka.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Na lejoni të mos i tregojmë të gjitha sekretet e zanatit. Më mirë të mos i tregojmë se pastaj do të ngelemi pa punë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Duhet të pranojmë faktin që kuota është mekanizëm artificial, më falni që gjeta këtë fjalë të papërshtatshme, sepse duhet të nxisë një proces, që në këtë këndvështrim, të gjitha formulat, që lidhen me kuotën të mos ndërhyjnë në vullnetin e zgjedhësve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Murrizi, ju keni shumë të drejtë për këtë, por kjo është pjesë e procesit. Në qoftë se ne kemi vendosur dyshemenë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me lejoni të jap një përgjigje për këtë gjë, pasi është shumë e rëndësishme!

Zoti Murrizi, ka të drejtë për konstatimin, por, ndoshta, nuk ka treguar vëmendje për shkakun pse është kështu. Unë kam frikë se është burra-gra apo gra –burra, për shkak të agresionit të madh që bëjnë burrat ndaj gjinisë. Domethënë mund të mbijetosh në qoftë se bëhesh grua burrë, përndryshe nuk mbijeton dot dhe këtë gjë duhet ta pranojmë që faji është këtej, jo andej.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë dua t'ju sjell në vëmendje ndryshimet e fundit që u bënë në Kodin Penal lidhur me këtë aspekt, ku u bënë disa ashpërsime të dispozitave të fundit. Që nga koha kur u bënë këto ndryshimeve në Shqipëri nuk ka ndodhur gjë. Unë nuk dua të hap debat politik, por, praktikisht, nuk janë dënuar as subjekte elektorale, as individë, as përfitues dhe as shpenzues të parave. Çfarë ka ndodhur?! Ka ndodhur një rritje ekstreme e sensibilitetit të shoqërisë ndaj



fenomenit. Domethënë, vërtet këto dispozita nuk kanë realizuar funksionin për të cilin u krijuan, por duhet të pranojmë se kanë rritur sensibilitetin e shoqërisë. Në këtë rast unë shikoj një impakt pozitiv për sa u përket ndryshimeve që ndodhin. Në qoftë se ne do të ndryshojmë Kodin Zgjedhor, por edhe dispozitat deklarative, siç tha Viktori, do të ishte një angazhim solemn i kryetarit të partisë për të mos ndjekur më politikën e blerjes së votës. Shumë njerëz mund të thonë se kjo është një broçkull dhe se atyre nuk u duhen dispozitat deklarative. Unë mendoj se një dispozitë deklarative që ka efekt në shoqëri, sepse rrit sensibilitetin; ka efekt edhe për shumicën e kryetarëve të partive, sepse i bën ata të frenohen, të marrin masa dhe të bëjnë deklarime në favor të rregullshmërisë së procesit zgjedhor, si dhe të eliminimit të politikave të manipulimit të zgjedhjeve.

Unë nuk do t'i vendos përballë apo kundër njeri-tjetrit Kodin Zgjedhor dhe Kodin Penal se cili është i mirë dhe cili është i keq; cili ka efekt dhe cili nuk ka efekt, sepse në fund të diskutimit zgjidhja na vjen nga shteti ligjor. Në qoftë se në Shqipëri sundon shteti ligjor, nuk ka fenomene të blerjes së votës dhe sundim i shtetit ligjor do të thotë respektim jo vetëm i njërës, apo më shumë i njërës dhe më pak i tjetrit, por i të dy kodeve. Pra, kuadri ligjor duhet të respektohet dhe të zbatohet me vullnet nga kandidatët. Nuk duhet ekzistojë më strategjia e një kandidati, i cili përdor shprehjen: “Unë do të zgjidhem se kam lekë”. Kjo nuk mund të ndodhë sot, nuk duhet të jetë kështu, por, gjithashtu, do të vijë në proces. Këtë vetëdije ndoshta do të na e sjellin gratë, apo jo, zonja Hysi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** - Kam dy pyetje për ekspertët.

Së pari, lidhur me formulimin, a keni ju redaktorë? Ka ndodhur shpesh që draftet këtu vijnë me interpretime të gabuara nga mospërdorimi i termave të gjuhës shqipe. Çfarë ndodh? Kur interpretohet gjëja, ne duhet të hapim fjalorin e gjuhës shqipe për të parë nëse një term i përdorur është i saktë apo jo. Rëndom edhe në këtë material konstatoj probleme, kjo ndoshta edhe për shkak të termave të përdorura gjatë transponimit të praktikave ndërkombëtare. Nëse doni, edhe mund t'ju listoj, por nuk dua të zgjatem. Pra, a keni ju redaktorë apo bashkëpunoni me redaktorë, në mënyrë që të ruajmë gjuhën shqipe dhe termat e duhur? Nëse nuk keni, mund të merrni redaktorët e Kuvendit?

Së dyti, duke iu referuar nenit 3, që, në mos gaboj, ndryshon nenin 4, ku thuhet: “Kur informacioni, sipas pikës së mësipërme, konsiderohet veprimtari që keqpërdor burimet njerëzore”. Ku do t'i referohet, sepse deri tani ka një vakuum ligjor? Prandaj, ne duhet ta plotësojmë këtë gjë në mënyrë që KQZ-ja, edhe sikur të mos ketë një definicion shterues, të

ketë një kuadër orientues, ose t'i japim mundësi të nxjerrë saktë aktet nënligjore, në mënyrë që të mos e bllokojmë administratën në rast zgjedhësh.

Ne jemi dëshmitarë kur nëpunësit e administratës publike, për këtë gjë ka edhe të një task-force, nuk e ushtronin dot të drejtën e tyre kushtetuese për t'u marrë me veprimtari politike jashtë orarit të punës. Atyre u lejohet dhe kanë të drejtë kushtetuese që, jashtë orarit të punës, të merren me veprimtari politike, por ata ndihen të terrorizuar. Prandaj, ne duhet t'i bëjmë gjërat më strikte dhe të mos i bëjmë thjesht deklarative, sepse edhe kur i bëjmë në mënyrë të ashpër deklarative, do të kalojmë në efekt të kundërt, duke e terrorizuar opinionin në ushtrimin e të drejtave të tyre kushtetuese.

Së treti, ju iu referuat disa transaksioneve, për shembull, në nenin 25, pika 5, ku flisni për 30-mijëlekëshin. A keni ndonjë praktikë, që i referohet këtij neni? Unë mendoj se duhet t'i referohemi edhe legjislacionit fiskal, Kodit të Procedurave Tatimore, sepse ka referim për transaksionet kesh, të cilat janë të detyrueshme për t'u raportuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Bashkim, të lutem! E keni ulur ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Damian Gjijnuri** - Zoti Fino, ju lutem, mbylleni këtë debat!

**Alket Hyseni** - Për shembull, në nenin 25, pika 5, 30-mijëlekëshi referohet si një shumë e detyruar për t'u raportuar. Ndërkohë, Kodi i Procedurave Tatimore, legjislacioni fiskal, ka një kuotë më të lartë. A mos ndoshta po u biem pak në qafë? Unë kuptoj se ne duhet të bëjmë shpesh edhe kapërcime, edhe praktika, të cilat e tejkalojnë një praktikë normale, pasi ia kemi bërë vetes me zullumet që janë bërë në të kaluarën. Unë mendoj se duhet të jemi më profesionalë, në mënyrë që kjo dispozitë t'i rezistojë kohës, por edhe të transponohet me dispozitat e legjislacionit fiskal. Unë mendoj se do të ishte mirë, edhe për aq sa është parashikuar atje, të bëhet e detyrueshme për individët.

Unë dua të jap një shembull, sepse kuotat janë më të lartat. Pra, në dijeninë time ne kemi kategori të partive politike që kuotën e anëtarësisë e kanë më të lartë. Ato i deklarojnë si raportime kuotash, por këtu nuk duhet të futen me numër kaq të ulët, pasi do të krijonin probleme kur të bëjmë dispozita. Pra, nëse nesër këto dispozita nuk do të zbatohen në praktikë, atëherë ne kot që i bëjmë pastaj, sepse në këtë mënyrë zhbëjnë edhe gjerat e tjera. Këto kisha si shqetësime të parat. Unë jam dakord për sa i përket tabelës që tha kryetari, sepse do të ishte mirë që t'i kishim me tabelë.

**Ilir Rusmali** – Do t'i përgjigjem relativisht shpejt.

Së pari, çështja e redaktimit është çështje e procedurës së brendshme parlamentare. Në fund të gjitha aktet kalojnë te redaktori. Kjo quhet zbardhje e projektligjit, ndaj modifikime apo saktësime të terminologjisë, për shkak të zbardhjes ndodhin gjithmonë. Kjo është pjesë e redaktimit që bëhet këtu dhe ne nuk mund ta sjellim paraprakisht të redaktuar dispozitën, sepse është draft.

Së dyti, unë u përpoqa shtjelloj pak se cila është ndërhyrja në raport me keqpërdorimin e burimeve njerëzore. Komponenti i dytë i rëndësishëm i ndërhyrjes është vendosja e rregullave strikte për KQZ-në, në gjykimin e saj, se cilat janë veprimtaritë që lejohen dhe cilat nuk lejohen. Katalogu i famshëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është te kapitulli përkatës, por ende nuk kemi ardhur aty.

I gjithë produkti i financimit është produkt i debatuar gjatë ndër vite dhe është debatuar nga të gjithë aktorët e mundshëm, që mund të përfshihen te procesi dhe 300-mijëlekëshi është rezultat i kësaj konvergjence opinionesh lidhur me ...

**Viktor Gumi** – Për sa i përket fjalisë së fundit për 30 mijë lekët e rinj apo 300 mijë lekët e vjetra, është diskutuar dhe nga i gjithë studimi që është bërë është konkluduar që anonimati që i sigurohet donatorit sot në Shqipëri është për 1 milion lekë të vjetra. Pra, kur depoziton 900 mijë lekë nuk i bëhet publik emri, kurse kur depoziton 1 milion e 1 lekë i bëhet publik emri.

Me mendim unanim të ekspertëve, por edhe të tryezës, ky kufi është shumë i lartë, sepse siguron mundësi që të fshihen shumë. Pyetja është nëse duhet ulur ky kufi. Rekomandimi i ekspertit të Këshillit të Europës, por edhe vende të tjera e kanë, është që kufiri të jetë afërsisht sa paga minimale e vendit. Pra, të sigurohet anonimati vetëm nëse je në kufirin e pagës minimale, kurse për pjesën tjetër mbi këtë pagë t'i duhet të bëhesh publik. Jo se të ndalon dikush ta dhurosh, por do të bëhet emri publik. Për shembull, iksi ose ipsiloni dhuroi 400 mijë lekë të vjetra për këtë subjekt. Për shumën poshtë 300 mijë lekëve është i tillë.

Së dyti, ne do të kemi luftë kundër blerjes së votës dhe përmirësim të procesit nëse ulim në maksimum shpenzimet e fushatës zgjedhore. Është një nga pikat e rekomandimeve të Këshillit të Europës për këtë gjë. Kemi vendosur edhe raportin 1 me 2 si tavan për shpenzimet, por edhe monitorimin nga ana e KQZ-së. Pra, do të ketë edhe gjëra të tjera, të cilat do të vijnë përsëri me dispozitat përkatëse, sepse këto ishin katër detyrat që morëm vetëm për këtë pjesë. Do të shikohet në tërësi dhe në fund Kodit do t'i bëhet një rekomandim përfundimtar nga ana e teknikës, sepse këtë gjë që bëjmë tani mund ta kemi me një fjali tjetër. Ligji për radiotelevizionin publik dhe atë privat ka një terminologji tjetër që nga viti

2013, janë operatorë audiovizivë apo diçka e tillë. Kështu që, detyrimisht këto do t'i kalojmë edhe në një filtër përfundimtar.

**Damian Gjikhuri** – Që të jemi edhe të kursyer me njëri-tjetrin, vendimmarrjen në fund do ta marrim ne. Ne do t'i debatojmë brenda nesh dhe do t'i përcaktojmë. Ekspertët na ndihmuan me këndvështrimin e tyre, nga janë frymëzuar për këto propozime, dhe mendoj që shumë prej propozimeve që u thanë këtu qëndrojnë.

Po, zoti Elezi.

**Arben Elezi** – Nuk dëgjova nga ekspertët mendime për çështjen e depolitizimit të administratës zgjedhore. Për kur është lënë, që ta dimë? Mendoj që kjo është shumë e rëndësishme.

**Damian Gjikhuri** - ... ekspertit që shumë shpejt do të na sjellin propozime për depolitizimin e administratës zgjedhore. Nuk kemi mbaruar punë, kështu që besoj se do të merrni përgjigje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka vazhdim.

Fjalën e ka Vasilika

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Mua më pëlqeu që një pjesë e mirë e kolegëve burra në komision adresuan pyetje për çështjen e barazisë gjinore. Unë pajtohem me shpjegimet që bëri eksperti Rusmali, përveç pjesës që unë e di shumë mirë qëndrimin që kur drejtonte komisionin që ka qenë kundër kuotës me argumentin që ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në këtë kuadër, unë kam dy pyetje për parashikimet që ju keni bërë në draftin që ne kemi përpara.

Së pari, qoftë zoti Gumi, qoftë ju thatë që keni marrë në konsideratë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për kuotat gjinore. Sa janë marrë në konsideratë rekomandimet që kanë bërë organizatat e grave në Shqipëri? Pyetja e dytë ka të bëjë me një shqetësim që ne kemi hasur, me faktin që shpesh gratë kandidate që ju ka ardhur radha për të marrë mandatin, nuk e kanë marrë atë dhe mandati i ka kaluar përsëri një burri. Ky është një fenomen që ne e hasëm në legjislaturën e kaluar. A ka modele dhe a e keni diskutuar mes jush si mund ta shmangim këtë lloj presioni që nuk është publik, por që ka ndodhur në realitet? Këto janë dy pyetjet e mia për çështjet e kuotave dhe të barazisë gjinore.

Mua më vjen mirë, zoti Murrizi, që ju e mbështetët çështjen e kuotave dhe më pëlqeu fakti për pyetjet që bëtë në lidhje me kuotat gjinore, sistemin, administratën, që mendoj se do të jetë e depolitizuar, që do të shkoj drejt zvogëlimit, për të riparë raportet.

Pyetja tjetër ka të bëjë me katalogun e disa veprimtarive që mund të konsiderohen fushatë elektorale. Mua më pëlqen kjo gjë dhe ajo nuk mund të ezaurojë çdo gjë. Ky katalog do të jetë në ligj, sepse nëse do të jetë në ligj besoj se do të bënim një gabim shumë të madh? Do të jetë në ndonjë udhëzim? Do të jetë në ndonjë vendim që do të marrë KQZ-ja. Cilat janë modelet? A ka ndonjë vend tjetër ndonjë katalog të veprimeve që konsiderohen si veprime që janë fushatë elektorale apo është një shpikje që ne e bëjmë për shkak të problematikave që kemi konstatuar në Shqipëri?

Faleminderit!

**Viktor Gumi** – Po e nis pikërisht nga momenti i fundit. Nuk po bëjmë shpikje, por përgjithësisht në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it këto janë thënë edhe si ndikime të administratës dhe keqpërdorime të burimeve shtetërore. Në një rekomandim të vitit 2017 është shkruar shumë qartë që shpërndarja nga Kryeministrit e lejeve të legalizimit është keqpërdorim i fushatës zgjedhore. Pra, kategorizimi i këtyre hileve që përdor administrata shtetërore, si një material bruto të parë, ne mund ta gjejmë në të gjitha rekomandimet. Inaugurimi i rrugëve apo shpërndarja e lejeve të legalizimit janë të cituara në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Pra, baza për të hartuar këtë katalog ekziston në këto rekomandime të OSBE-ODIHR-it. Duhet ta përjasim dhe është një proces, që sikundër e theksoi zoti Rusmali, dinamik. Tani ne po krijojmë një traditë dhe kësaj tradite, nga një rekomandim, po i japim vlerë ligjore me sanksion. Ligji nuk mund të shkruhet në detaje, por duhet të ketë parimin dhe do t'i delegohet KQZ-së për të përcaktuar me modalitet këtë katalog, me akt normativ të vetin, të bërë publik, të hapur edhe për denoncime në portal, dhe gjithashtu të ndryshueshëm. Në çdo moment që KQZ-ja shikon një shkelje, kërkon amendimin e këtij kodi.

Është e nevojshme të shikojmë, sepse efekti i saj është që në këto zgjedhje bëme hapin e parë, zgjedhjet e tjera hapin e dytë. Ky do të jetë proces në përmirësim dhe në adaptim në këtë pikë.

Vlerësojmë që, së pari, duhet të ketë parimet kryesore kur të vijmë te pjesa përkatëse, aq sa mund t'i ketë në kuadrin e gjuhës normative të ligjit, parim i njëjtë edhe për teknologjinë edhe për votën e emigrantëve dhe një lirshmëri të KQZ-së me akt normativ, të bërë publike përpara zgjedhjeve, kush përbën keqpërdorim të fushatës në këtë pikë.

Së dyti, në lidhje me raportin e organizatave të tjera, ne kemi qenë në dijeni. Për shkak të statusit kemi pasur, gjithashtu edhe dokumentacionin që këto organizata kanë dhënë. Gjithashtu, kanë paraqitur mendimet e tyre në seancat dëgjimore të komisionit të mëparshëm në lidhje me këtë pikë.

Patjetër janë marrë në konsideratë, janë reflektuar, por jo mot-a-mot, me gjuhën që ato propozojnë, sepse ne kemi thënë që objektivi është i njëjtë. Jo më pak se një në tre emra konsektivë t'i përkasë në rastin e zgjedhjeve për parlamentin gjinisë më pak të përfaqësuar. E dyta, sanksioni është i qartë, nuk do të ketë më gjobë, por refuzim liste.

Në lidhje me procesin, që ka ndodhur në dy legjislatura, të zëvendësimit të grave me tekst dorëheqjeje me element burra, edhe kësaj i kemi dhënë një zgjidhje. Kemi thënë: një deputete grua, e gjinisë më pak të përfaqësuar, gjithmonë do të zëvendësohet nga një deputete e gjinisë më pak të përfaqësuar. Kur mbaron lista brenda partisë, nuk ndërpritet dhe kalon te burrat e partisë, por kalon te partia e dytë e koalicionit me herësin më të madh, e cila merr gruan.

Kjo nuk është shpikje që e bëjmë ne, por është shpikje aktuale. Në rast se mbarojnë mandatet, mandati kalon te partia e dytë e koalicionit. Kur nuk ka koalicion, vjen partia politike, ezaurohet kjo praktikë, ka gjobë dy milionë lekë të reja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjiknuri** – Keni ndonjë shtesë?

**Illir Rusmali** - Ne kemi menduar edhe një gjë tjetër, që ndoshta e ndihmon sensibilitetin e shoqërisë ndaj fenomenit. Në rastet e mëparshme nuk ka pasur reagim zyrtar ndaj kësaj manovre të kundërligjshme. Ne kemi detyruar KQZ-në me këto amendamente që të mbaj qëndrim zyrtar në rast se ndodhin fenomene të tilla, si institucion përgjegjës për garantimin e barazisë gjinore. Besojmë se këto e ezaurojnë për momentin.

Ne mund ta rëndonim dorën më shumë. Kemi edhe ente, mekanizma rezervë, por thamë se do të ketë edhe reforma të tjera dhe pse t'i mbyllnim të gjitha këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjiknuri** – Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Myslim, të mundohemi të jemi racionalë. Jo të gjitha do të shterohen tani. Jeta është mësim-pësim, *try and error*. Kështu është jeta. Ne duam t'i zgjidhim të gjitha këtu!

E rëndësishme është që këtu po futen disa parime të reja, të cilat do të na imponojnë sjellje tjetër.

Zoti Gjoni, flisni shkurt.

Mendojmë t'i përmbledhim pyetjet dhe të mos vazhdojmë më me to, sepse do të marrim kohën tonë.

**Ralf Gjoni** – Nuk kam më diskutime. Kam qenë shumë konciz dhe teknik sot.

Nuk e di nëse do të biem dakord të votojmë në parim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa bezdiseni...!

**Damian Gjikhuri** – Fol, se vetëm ti e ke këtë problem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka diskutim, por pyetje.

**Ralf Gjoni** – Nuk po kërkoj diskutim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetje po bëj.

**Damian Gjikhuri** – A do të pyesësh? Nuk ka...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, kryetar!

Jemi te seanca e pyetjeve. Kam kërkuar fjalën për pyetje. Në qoftë se do të ngatërroni pyetjet me diskutimet, na e thoni. Tani do të vazhdoj me pyetjet që kam.

Çështjet e barazisë gjinore mendoj se u ezauruan. Kështu që nuk po marr kohë.

Thjesht dua të nënvizoj faktin që ekspertët, duke qenë se unë kam qenë edhe pjesë e grupit të punës të shoqërisë civile, i kanë adresuar kërkesat që kanë pasur të gjitha organizatat në lidhje me bërjen efektive të mekanizmave për përfshirjen e grave në politikë. Filozofia për të pasur në rezultat barazi gjinore dhe jo në proces, është pikërisht ajo që i duhet shoqërisë shqiptare. Ka mbi 10 vjet që punojnë të gjithë aktorët në shoqërinë civile, por edhe aktorët politikë. Këtë do të doja ta nënvizoja për t'ju falënderuar për qasjen që keni pasur!

Pyetjet e mia lidhen me pjesën e grupit të punës ku bëj pjesë, për financimet e partive politike.

Unë shoh se fryma (nëse nuk gabohem), që parashikojnë propozimet që bëni, ka të bëjë me auditin e fondeve që marrin subjektet politike për aktivitete të fushatave. Pra, *post*, mbasi është kryer financimi, do të auditohet nga KQZ-ja se si është realizuar ky financim dhe nëse ka qenë në përputhje me kriteret që ka parashikuar ligji.

Çështja e parë ka të bëjë me faktin se nuk shoh që KQZ-ja të ketë një tagër për të mbajtur paraprakisht, pra para se të vijë momenti i auditimit, deklarimin nga partitë politike të një financimi që marrin. Ndoshta e kam gabim, ndoshta është, por me kaq sa e kam lexuar unë materialin nuk është.

Mendoj që, nëse do të kemi edhe një detyrim për ta deklaruar paraprakisht, do të ndikojmë në qëllimet parandaluese, që të gjithë së bashku kemi vendosur t'i kemi prioritet, pra që të mos lejojmë ndërhyrjen e të tretëve për qëllime keqdashëse në proceset zgjedhore, qofshin subjekte vendase, qofshin të huaja. Nisem nga të gjitha situatat politike që po kalon jo vetëm Shqipëria, por edhe vendet e tjera, deri në Amerikë, me ndërhyrjen e të tretëve në proceset zgjedhore.

Nëse ka qenë kjo qasje, dakord, por do të duhet ta sqarojmë. Nëse jo, mendoj se edhe në grupin e punës, bashkë me ekspertët, do të punojmë për këtë qasje dhe do të duhet ta thellojmë.

Së dyti, kam diçka në formën e pyetjes dhe të sugjerimit. Po hymë te dispozitat e Kodit të Zgjedhor, siç kemi synimin, për financimin e partive politike në fushatat zgjedhore, kam përshtypjen se prekim edhe ligjin për partitë politike, sepse edhe atje ka dispozita në lidhje me financimet e subjekteve politike. Duhet t'i harmonizojmë dhe të shohim nëse kemi ndonjë kundërshti, që të mos na ndodhë që ndryshe të thotë një ligj dhe ndryshe të thotë Kodi Zgjedhor, pavarësisht se ky i fundit do të përvëlojë. Ne jemi në këto kushte, vendosim së bashku dhe parlamenti merr vendime për të dyja ligjet. Mirë është ta shohim pak harmonizimin e ligjit me këtë nismë të Kodit Zgjedhor, për ndryshimet që jemi duke bërë dhe ndoshta të punojmë për propozime konkrete në mbledhjen e radhës.

E di që ligji për partitë politike është shumë i vjetër. Kam pasur sugjerime dhe e kemi diskutuar disa herë me bashkëkryetarin e Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe me shumë kolegë të tjerë, që, në kuadrin e reformës zgjedhore, është mirë që pjesë e paketës të jetë edhe ligji për partitë politike, sepse ai jo vetëm është i vjetruar, por edhe situatat kanë ndryshuar kaq shumë, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën dhe ka nevojë për një rregullim me një dinamikë më të gjerë nga ajo që ka qenë kur është miratuar ligji.

Kjo është për diskutim. Është edhe mendim politik, por të paktën të shohim një herë ndikimin e ndryshimeve që propozohen në Kodin Zgjedhor për financimin e partive politike me atë që parashikon për këtë pjesë ligji për partitë politike.

Faleminderit!

**Viktor Gumi** – Në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, por edhe për çfarëdolloj formulimi që kemi paraqitur, ne nuk jemi konservatorë, që e kemi shkruar në gurë këtë dhe nuk e prekim. Në dijeninë tonë ky është një draft që do t'i çohet shoqërisë civile, do të hapet për diskutim dhe do t'i rishikojmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Jo, në kuptimin që ne i rikthehemi çfarëdolloj gjejë që mund të dalë gjatë procesit në këtë pikë.

Për pyetjen e dytë, për praktikën e fundit, kemi marrë dhe kemi transpozuar nga çështjet e ligjit për partitë politike, pjesët që janë te Kodi Zgjedhor, që duheshin bërë, sepse është edhe rekomandim i OSBE-ODIHR-it, që ka rregullime të ndryshme dhe... Kodi gjithmonë prevalon, sepse ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese për këtë pikë. Pra, në lidhje me këtë pjesë, në mënyrë teknike dhe formalisht, kërkon një shfuqizimi të dispozitave të caktuara edhe të ligji për partitë politike.

Së treti, në lidhje me deklarinimin paraprak, në tekstin e dispozitës, që është një çështje që është diskutuar shumë, është parashikuar edhe një rol aktiv i KQZ-së gjatë fushatës zgjedhore, si me portalin, ashtu edhe me elemente të tjera të monitorimit. Pra, cakton monitorues, të cilët bëjnë llogaritje mbi bazën e metodologjisë që bën KQZ-ja dhe ia çojnë për mendim KQZ-së. Në çdo rast është një çështje që duket midis balancës së drejtë, realizimit të lirë dhe të plotë të një fushate, sepse financimi në vetvete është e drejta e shprehjes (jurisprudenca amerikane, e drejta e opinionit politik), që partitë politike të kenë lirshmërinë për të vepruar dhe për të mos u ndier të diskriminuara në kuptimin e pengesës për realizimin e fushatës.

Nga ana tjetër, organi administrativ, paralelisht, gjatë zhvillimit të fushatës, pra jo *post factum*, është i detyruar të bëjë vëzhgimin e tij dhe të marrë raportime nga administrata.

Për sa i përket çështjes së portalit, dikush mund të paraqesë ndonjë ankesë. Sot KQZ-ja e ka me akt nënligjor këtë procedurë: shqyrton ankesat e të tretëve në lidhje me financimin e partive politike.

Gjykojmë se paralelisht me fushatën, auditimin *post factum*, si para, si pas, KQZ-ja ka kompetencën e verifikimit. Ndryshimi kryesor që është bërë është se KQZ-ja ka rol parësor, kërkon të marrë kontakt drejtpërdrejt. Nëse do të jetë në stilin e vet më ideal, procedura duhet të jetë e vetingut: “Deklarove 1 milionë lekë? Po. Më thuaj se ku i gjete 1 milion lekë.” Në këtë pikë, ky është detyrimi që është parashikuar në lidhje me KQZ-në.

Për sa i përket ekzistencës së deklarimeve paraprake ka qenë një ide në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, që çdo javë të bëheshin deklarime paraprake. Duket se edhe eksperti i Këshillit të Europës, edhe gjatë diskutimeve, është tërhequr nga kjo ide. Pra, diku shfaqet që ekziston si deklarinim paraprak dhe pastaj në rekomandimet e fundit nuk përmendet kjo pikë. Duket se është një çështje paragjykimi, pra futje në fazë, deklarohet paraprakisht dhe pastaj kalon në procedurë kontrolli. Cila është vlera e deklarinimit paraprak?

Po përse?

**Klotilda Bushka** – Si e gjykoj? Kam vetëm një fjali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Grupi ynë i punës këto çështje do të diskutojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vlera është te fakti që, nisur nga problematikat, ku stisen më mbrapa për auditim çështjet e financimeve dhe raportimeve, në momentin kur raportimi ose deklarimi bëhet paraprak, ka më pak hapësirë për abuzime...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord. Është çështje për diskutim në grupin e punës.

**Damian Gjikuri** -...për t'u diskutuar në një tavolinë të ngushtë. Është shumë teknike.

Ilir, mendoj se i ezauroi Viktori.

**Ilir Rusmali** – Meqenëse e keni, duhet parë si çështje parimore.

Ka shumë zgjidhje dhe alternativa. Një pjesë e tyre mund të jenë edhe atraktive. Duhet mbajtur në konsideratë dy gjëra, që janë fundamentale në çështjen e financimit: së pari, ka një standard, që është i praktikave të mira, i cili nuk lejon ngarkimin me barrë joproporcionale të subjekteve elektorale në raport me deklaratimet dhe, së dyti, niveli i mendimit ndërkombëtar për këtë çështje është më i ulët seç e mendojmë ne ose seç e kemi ligjërisht. Prandaj duhet një lloj frenimi nga ana jonë kur diskutojmë këtë tematikë. Thonë të mos u ngarkoni shumë detyra subjekteve politike, sepse i pengoni në veprimtarinë e tyre për fushatë.

E dyta, e cila mendoj se është më e rëndësishme, transparenca në fushatë, që është e admirueshme për shumë veta, mund të dëmtojë procesin, fushatën në vetvete, zgjedhjet si proces, sepse mund të shndërrojë, pa dashjen e palëve, tematikën e financimit në çështje fushate, në debat elektorale. Kjo i prish zgjedhjet në këndvështrimin dhe impaktin që ato kanë te njerëzit. Njerëzit kanë nevojë të dinë platformën politike, kanë nevojë t'i shikojnë konkurrentët në këtë këndvështrim, jo sa para harxhon njëri dhe sa para harxhon tjetri. Në momentin që ne e shtojmë dozën në këtë linjë, mbase mund të dëmtojmë procesin në vetvete. Ky ekuilibër duhet ruajtur me shumë xhelozë.

**Damian Gjiknuri** – Shumë e qartë.

Me mirëkuptim, mund t'i përmbledhim pyetjet, që të vazhdojmë pjesën tjetër, sepse duhet të bëj edhe disa anoncime, që i vlejné punës së mëtejshme, nëse nuk ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

**Ralf Gjoni** – E fillova më parë dhe nuk e kuptova nivelin e turrjes.

Pyetje teknike për funksionimin e komisionit: për ekspertët, për shkak se ne kemi një kauzë politike, që nuk ju përket juve, por lidhet me ndryshimin e sistemit zgjedhor, a është e mundur që teknikisht të identifikohen nenet e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, të cilat në gjykimin tuaj nuk varen nga një ndryshim eventual i sistemit gjatë javëve ose të muajve në vazhdim dhe nenet që përmenda paraprakisht në fillim të seancës së sotme, të lihen jashtë dhe të trajtohen në një moment të dytë? Sepse unë nuk mendoj se në pozitën tonë si opozitë ne ndihemi rehat me idenë e miratimit në parim të disa neneve, thjesht me premtimin ose me prezumimin juridik të idesë që më vonë, nëse votojmë diçka tjetër, kjo zhbëhet. Pra, bën sens pyetja? A është e mundur të identifikohen ato nene, që nuk bien ndesh me një ndryshim eventual sistemi?

**Damian Gjikhuri** – Mirë e keni, zoti Gjoni, por çfarë të bëj?

**Ralf Gjoni** – Mund ta kemi këtë lloj kujdesi, mund të vëmë shënimin në fund të dispozitave që bëhen gati, që kjo do të rishikohet kur të gjykohet sistemi, mund t'i heqim. Domethënë, është volem pune.

**Damian Gjikhuri** - Kjo nuk varet...

**Ralf Gjoni** – Kjo është një punë që duhet ta bëni ju, ose sot, ose nesër. Nuk është puna jonë.

**Damian Gjikhuri** – Ilir, do t'ju jap unë shpjegim për këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të japësh, sepse këtu është vendimmarrja, po ta jap unë. Tjetër gjë është nëse e vendosim ne. Ekspertët bëjnë çfarë themi ne. Vendimmarrja është këtu, ti dhe unë. Nuk kemi nevojë t'i ngarkojmë ata.

**Ralf Gjoni** – Sa herë flas, më drejtoheni në këtë mënyrë. Çfarë keni?

**Damian Gjikhuri** – Mos u bëj çimkë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po normale, nuk i ke ti në dorë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush të llogarit ty për atë pjesë, zotëri?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ik, zotëri! Ti nuk je votuar ndonjëherë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ik!

**Ralf Gjoni** – Mos ofendo!

Shiko veten tënde në pasqyrë!

**Damian Gjikhuri** – Të lutem, biseda u bë e tillë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Alket, ta përmbledhim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Rekomandimet janë rekomandime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ralf Gjoni** – Me çfarë të drejte ofendon?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** - Zoti Gjoni, ju lutem, e thatë opinionin tuaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Alket, ta përmbledhim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** - Jam më i vjetër se ty, siç jam më i madh se ty në moshë, sepse do të kisha qejf të isha më i ri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pusho!

**Ralf Gjoni** – Vasilika, më falni, ju duket normale që kolegu juaj e quan ...

**Alket Hyseni** – Veprimi juaj është veprim skuthi. Unë thatë: “mos u bëj”, nuk thash “je”.

**Ralf Gjoni** – Unë bëj një pyetje dhe kryetari juaj thotë: “E ezauruam atë”.

**Damian Gjikhuri** – E ezauruam.

Do të jap unë përgjigje, sepse ramë dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E thënë ndryshe, të gjitha rekomandimet e ODIHR-it...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po vijnë këtu, dhe ai ta tha shumë drejtë, që çdo gjë që miratojmë ne këtu, dhe nuk po miratojmë gjë, nuk po çojmë asgjë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ti ke të drejtën e vetos.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

**Ralf Gjoni** – Ti ke blerë vota.

**Damian Gjikhuri** – Lëre, lëre!

Ku kupton ti nga vota.

**Ralf Gjoni** – Turp për ty.

**Damian Gjiknuri** – Ik, zotëri, sepse nuk kupton ti nga vota! Ti nuk merr vesh nga ato punë. Rri aty!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Të përmbledhim diskutimet.

Çfarë propozuam në fillim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos prano! Ik!

Pyetjet do t'i përmbledh në këtë pikë.

Seanca tjetër do të vazhdojë në këtë mënyrë, sepse e kemi diskutuar edhe me bashkëkryetaren, që të mos humbim qetësinë dhe të kemi në fokus objektivin.

**Rudina Hajdari** – Ju lutem, nuk mund të ketë ofendime!

**Damian Gjiknuri** – Nuk ka ofendime.

**Rudina Hajdari** – Ju lutem, ju iu drejtuat anëtarit me ofendime.

**Damian Gjiknuri** - E kupton çfarë bëri ai? Të të bëj unë foto ty, pse ike ti nga mbledhja.

**Rudina Hajdari** - Dakord.

Ka qenë edhe Kryeministri, që ka bërë foto në Kuvend dhe e keni shfrytëzuar sa herë keni dashur.

**Damian Gjiknuri** - Nuk ndodh, sepse ky është komision pune.

**Rudina Hajdari** – Nuk është çështja aty, sepse ka bërë edhe Kryeministri shumë foto ndaj grupit parlamentar. Kanë ndodhur këto incidente. Është pjesë e praktikës ...

**Damian Gjiknuri** - Zonja Hajdari, është hera e parë që ndodh në Komisionin e Reformës. Gjithmonë kanë qenë bashkë PD-PS, por puna ka shkuar fjollë.

**Rudina Hajdari** – Zoti Gjoni, të gjithë kanë qenë shumë konstruktiv. Nëse kanë dëshirë, që ata të bëjnë pyetje, dhe të vazhdojnë të bëjnë të njëjtën pyetje, edhe ekspertët janë këtu dhe kanë durimin e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve. Zoti Gjiknuri, ju si bashkëkryetar, edhe ne, duhet të jemi ata që të kemi durimin më të madh nga të gjithë anëtarët e tjerë. Nuk është e drejtë që ju t'i drejtoheni një anëtari të opozitës në atë lloj mënyre. Më vjen keq! Unë nuk i jam drejtuar absolutisht asnjë anëtari.

**Damian Gjiknuri** – Ti nuk ishe këtu 2 orë.

**Rudina Hajdari** – Nuk ishte 2 orë, ishte gjysmë ore. Nuk e di çfarë ka ndodhur, nuk pretendoj të di çfarë ka ndodhur, por në momentin që shikoj një koleg, i cili thotë: “Dua t'i

drejtohem me të njëjtën pyetje”, për të cilën ju thatë se është ezauruar, le ta përmbledhim, ne i përmbledhim pikat bashkërisht kur të gjithë anëtarët e komisionit të jenë të ezauruar nga pyetjet dhe iu është mbushur mendja plotësisht për këtë gjë, sepse secili ka të drejtën e vetë të bëjë pyetje.

E kuptoj, por ka secili të drejtën e vetë të bëjë pyetje.

Kjo është gjëja më e rëndësishme që ne kemi në axhendën tonë. Sot për sot në Shqipëri kjo është axhenda më e rëndësishme.

**Damian Gjikhuri** - Zonja Hajdari, sepse është gjynah të priset e gjithë kjo punë e mirë e krijuar vetëm nga një individ.

**Rudina Hajdari** - Ti nuk mund të bezdisesh.

**Damian Gjikhuri** – Besdisem.

Ata e kanë zekthin brenda, megjithatë nuk kemi çfarë t’u bëjmë, sepse njerëzit janë të ndryshëm. Këtu ka aksidente historike, ndaj do të jetojmë me to dhe nuk kemi çfarë të bëjmë, sepse jemi të detyruar të punojmë bashkë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ata janë kundërshtarë tani.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, e keni ezauruar atë pikë.

Unë ju thashë për sistemin, ndaj sillni propozimin, do të bëjmë diskutimet, sepse nuk e nxjerrë nga axhenda. Zoti Murrizi e tha në fund dhe e tha shumë mirë: “Ne nuk do të pranojmë asnjë lloj kompromisi pa miratuar sistemin dhe pa shkruar draftin”. Pra, këtu e kemi mbyllur. Që të bëhemi konkretë, unë propozoj që ta publikojmë draftin që kemi këtu në faqen e internetit të Kuvendit, sekretaria t’i dërgojë draftin zyrtarisht të gjitha organizatave joqeveritare, KQZ-së, Ministrisë së Brendshme, sepse ka disa detyra edhe për Ministrinë e Brendshme për komente, dhe të gjitha partive politike të interesuara, si pjesë e parë e punës, dhe nga ekspertët kërkoj të përgatisin relacionin përkatës për çdo nen. Pra, nga jemi nisur dhe cili ka qenë racional, në mënyrë që ato të publikohen në faqen e Kuvendit, që çdokush ta shikojë se cilat kanë qenë arsyet, qëllimet, sepse edhe neve si komision na e lehtëson punën për të ditur se cili ka qenë racionaliteti pas çdo propozimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neve do t’ua çojmë zyrtarisht të gjithëve, Partisë Demokratike dhe partive të tjera, pra të gjithë aktorëve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë propozoj që pasi të biem dakord me bashkëkryetaren e komisionit, të organizojmë një konferencë të hapur me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, që duhet ta përcaktojmë bashkë.

Së fundi, ju njoftoj se OSBE-ja për çështjen e financimit të partive është duke përgatitur një aktivitet së bashku me Këshillin e Europës, që grupi i ngarkuar për financimin e fushatave zgjedhore dhe partive politike të jetë shumë e involvuar në mënyrë direkte, që edhe kjo konferencë të dalë me konkluzionet e duhura, në mënyrë që të na vijë një produkt i mirë për t'u adresuar.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Damian Gjiknuri** - Çfarë lidhje ka kjo tani?!

Atëherë, ju falënderoj shumë!

Ju kërkoj ndjesë edhe për ndonjë ngritje zëri pa dashje, por e rëndësishme është që ne po kalojmë një paketë të rëndësishme.

## **MBYLLET MBLEDHJA**